

**CEREMONIA FESTIVE E
80 VJETORIT TE KRIJIMIT TE
GARDES SE REPUBLIKES
SE SHQIPERISE**



24 QERSHOR 1928-2008



GARDA



108 ISMITH I GJASHTË J BO DAVET QERSHOR 2008



REVISTE PERIODIKE E GARDES SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

BOTOHET NEN KUJDESIN E KOMANDANTIT TE GARDES
Gjeneral Ndrea PRENDI

PERMBAJTJA

- *Fjala e Kryeministrit Sali Berisha në Samitin e Parisit: "Procesi i Barcelonës: Bashkimi për Mesdheun* - faqe 4
- *Imazh i ri performance e dukshme* - faqe 5
- *Garda 80+ ... Vjet - SIMPOSIUM*- faqe 6
- *80 Vjetori i krijimit të Gardes së Republikës 24 Qershor 2008* - faqe 12
- *Zhvillimi i fazes përfundimtare të implementimit të sistemit të ri page- grade- funksion organik* - faqe 22
- *Garde e Republikës force sigurie me standarde perendimore dhe performanance kombetare* - faqe 24
- *Normat e edukates dhe miresjelljes dhe etika e komunikimit*- faqe 26
- *Sporti dhe kultura si pjese e pandare ne jeten gardiste* - faqe 28
- *Si te mos biem "pre" e konsumimit profesional* - faqe 29
- *Per nje mendim elitar dhe nje elite intelektuale* - faqe 30
- *Poezia*- faqe 31

GARDA 80 VJET



24 QERSHOR 1928 - 2008 CEREMONI FESTIVE ME RASTIN E KRIJIMIT TE GARDES SE REPUBLIKES.



FJALA E KRYEMINISTRIT SALI BERISHA NË SAMITIN E PARISIT: “PROCESI I BARCELONËS: BASHKIMI PËR MESDHEUN”



I nderuar President Sarkozy,
I nderuar President Mubarak,
Shkëlqesi,
Zonja dhe Zotërinj,

Është një kënaqësi e veçantë për mua të marr pjesë në këtë Samit ku do të përurojmë së bashku, besoj, një fillim të ri, të madh dhe historik të marrëdhënieve pothuaj eternal e të gjithanshme, që kanë lidhur vendet dhe rajonet tona, që ndahen nga një det, i cili i bashkon sot ato në Bashkimin për Mesdheun.

Dëshiroj të shpreh me këtë rast falënderimet më të përzemërta për vendin mikpritës, Francën dhe Presidentin Sarkozy, si promotor i nismes së madhe Bashkimi për Mesdheun, si dhe për organizimin e shkëlqyer të këtij Samiti në Paris, kryeqyteti kaq shumë i lidhur me historinë, kulturën e kombeve dhe vendeve tona.

Më lejoni me këtë rast, i nderuar President Sarkozy, që ne emrin tim dhe të qeverisë shqiptare, t'ju shpreh ju dhe përmes jush, qeverisë dhe kombit të madh frances urimet më të përzemërta e me rastin e festës kombëtare të Francës, që do të kemi nderin ta festojmë së bashku, nesër. 14 korriku është një ditë e madhe historike që i përket jo vetëm kombit francez, por të gjithë qytetërimit perëndimor dhe mbarë njerezmit. Shqipëria e mbështet fuqishëm nismën Procesi i Barcelonës: Bashkimi për Mesdheun, dhe objektivat e saj për paqe stabilitet, siguri, integrim rajonal e kohesion. Ne besojmë se forcimi i dialogut politik dhe bashkëpunimit në të dy brigjet e Mesdheut është i domosdoshëm jo vetëm për Europën por ai ka edhe dimension global. Rajoni ynë është rajon i zhvillimeve të mëdha, i kulturave e qytetërimeve sa të lashta aq edhe të larmishme, por edhe i konflikteve pa zgjidhjen e së cilave paqja në botë nuk mund të jetë e sigurt. Shqipëria dhe shqiptarët me përvojat e dhimbshme që historia u rezervoi, si pushtimet, ndarjen, genocidin e izolimet e vetëshpallura apo të imponuara, por edhe me traditat e një kombi plurireligjioz, me tolerancë të shkëlqyer fetare, që nuk ka njour konflikte në tërë historinë e tij. Në Shqipëri është një qytet i lashtë që quhet Berat, i cili pak ditë më parë hyri në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Në këtë qytet ndodhet një kishë e shekullit të 16-të që unë e vizitoh shpesh, sepse njëra prej ikonave të bukura të saj, një foto të cilës e kam marrë sot me vete dhe po jua tregoj këtu, paraqet Shën

Marien me foshnjën Jezu në krah dhe në të dyja anët e saj ndodhen dy minare, dëshmi kjo e një respekti të thellë e të palëkundur të shqiptarëve për besimin e njëri-tjetrit. Simbol i tolerancës sonë të shkëlqyer fetare.

Gjithashtu shqiptarët me përvojën e tranzicionit e transformimit rrënjësor të vendit të tyre gjatë 16 viteve të fundit, si dhe me arritjet e jashtëzakonshme në projektet madhore kombëtare për integrimin europian dhe atë euro-atlantik kanë shumë për të ofruar në këtë proces. Ne jemi gati të ndajmë përvojën tonë me secilin nga vendet tuaja mike, anëtare të Bashkimit për Mesdheun.

Gjatë këtyre tre vjetëve të fundit, duke shndërruar reformat në perpetual mobile të saj, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE dhe po e zbaton atë me sukses. Me 3 prill të këtij viti mori ftesën për anëtarësim në NATO dhe më 9 korrik u nënshkruan në Bruksel protokollin e aderimit të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO. Duke shpresuar që vendet anëtare të ratifikojnë me përparësi protokollin e aderimit të Shqipërisë në NATO dëshiroj t'i siguroj ato se ne jemi të vendosur plotësisht të vazhdojmë reformat e thella e të gjithanshme dhe se me politikën tonë të jashtme do vazhdojmë të mbetemi një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon e më gjerë.

Të nderuar Kryetare Shtetesh dhe Kryeministra,
Të dashur miq,

Shqipëria vlerëson theksin që Procesi i Barcelonës: Bashkimi për Mesdheun i jep hartimit dhe realizimit të projekteve. Janë realizimet praktike, konkrete, të prekshme ato që ndikojnë e ndryshojnë jetën e njerëzve. Shqipëria është e interesuar në projektet konkrete të propozuara, në vecanti i kushtojmë vëmendje dhe interes të vecantë projekteve në fushën e infrastrukturave të mëdha, mjedisit dhe energjisë.

Krijimi i klimës më të favorshme për biznes e investime është një nga përparësitë më kryesore të qeverisë sime gjatë. Gjatë këtyre tre vjetëve, ne kemi arritur një revolucion të vërtetë fiskal, një thjeshtësim dhe ulje drastike të taksave. Kështu nga 23 taksat kombëtare aktualisht ekzistojnë vetëm 6. Kemi instaluar taksën e sheshtë 10% duke ulur nga 25 ne 10% tatim fitimit dhe nga 23 ne 10% tatimin mbi të ardhurat personale. Kemi ulur në 50% taksën e biznesit të vogël, 31%

sigurimet shoqërore, 33% çmimi i energjisë për bizneset. Sot, Shqipëria është vendi me taksën e sheshte më të ulët në Europë, në nivelin 10%.

Për të thjeshtësuar procedurat burokratike për biznesin, qeveria ime po instalon kudo procedurat "One Stop Shop". Biznesi sot regjistrohet në mënyrë elektronike për një ditë dhe me tarifë vetëm 1 Euro. Ekonomia shqiptare është e re dhe dinamike, ajo ka nisur këtë vit me rritje dyshifrore, me inflacion plotësisht të kontrollueshëm, eksportet janë rritur me 41%. Në hartë, vendi ynë është i vogël, por ka potenciale të jashtëzakonshme, turistike, ujore energjetike dhe minerare për investitorët e vendeve tuaja dhe tregun e punës më të favorshëm në Europë. Në Shqipëri u hoqën mbi 103 leje dhe licenca (rreth 70% në total), dhe kanë mbetur vetëm 62 të tilla të cilat do të përmblihen në "One stop Shop". Unë gjej rastin tu bëj thirrje të gjithë investitorëve të vendeve tuaj të vijnë dhe të eksplorojnë potencialet e jashtëzakonshme në burime e bukuri natyrore si dhe kapacitetet njerëzore që Shqipëria ofron. Qeveria shqiptare do të jetë përkrahësi dhe mbështetësi më i mirë i tyre.

Përpara se të përfundoj dëshiroj të shtoj dy fjalë mbi zhvillimet në rajonin e Ballkanit perëndimor, i cili si vazhdimësi e rajonit të Mesdheut ka një rëndësi jetike për paqen dhe

sigurinë e vendeve tona. Kosova prej dekadash ishte shtazan me fatin e saj. Me 17 shkurt, fëmija lindi; Kosova është sot e pavarur. Në rajonin tonë një fëmijë i ri ka lindur. Kosova po hedh hapat e saj të parë në ndërtimin e demokracisë më të re në Europë. Historia politike e legale e Kosovës, por edhe genocidi e fushatat e pastrimit etnik e bëjnë atë një rast unik që nuk krijon precedent. Kosova është njohur tashmë nga më se 42 vende.

Dua të theksoj se asnjë nga këto vende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës si një vendim për të ndëshkuar Serbinë, por as edhe për të shpërblyer shqiptarët. Ato kane njohur pavarësinë e Kosovës me bindjen me të thelle se kjo është rruga e vetme për të garantuar paqen dhe stabilitetin në rajon. Unë do t'ju drejtoj një thirrje miqësore, vendeve mike të pranishme në këtë Samit, të cilat ende nuk e kanë marrë këtë vendim, të shfrytëzojnë shansin për të dhënë kontributin e mëtejshëm në paqen në gadishullin tonë, duke njohur pavarësinë e Kosovës.

Duke përfunduar, dëshiroj të theksoj edhe një herë vendosmërinë dhe angazhimin e vendit tim për të qenë një partner aktiv dhe i vendosur për të kthyer këtë iniciativë të shumë-vlerësuar në një histori të vërtetë suksesi.

Ju faleminderit.

IMAZH I RI, PERFORMANCE E DUKSHME

E
D
I
T
O
R
I
A
L



Një vizion i ri i Gardës së Republikës filloi të realizohej që në vitin 2005 nga një staf i ri profesionistësh me pikepamje etiko-morale bashkëkohore dhe perëndimore.

Një vizion i ri për performancën, një vizion i ri për profesionalizmin, për kulturën, një vizion i ri për infrastrukturën, një vizion i ri për teknologjinë bashkëkohore, një vizion i ri për hulumtimet mbi historikun e Gardës, një vizion i ri mbi Muzeun dhe prezantimin e

vlerave historike të Gardës, një vizion i ri mbi ceremonitë festive, një vizion i ri mbi përgatitjen e trupave speciale për mbrojtjen e personaliteteve u kurorëzua më 24 qershor 2008, në 80 vjetorin e Gardës. Imazhi i ri filloi që pas vitit 2005. Imazhi u vu re para së gjithash që në konceptimin e përgatitjeve për festimet e 80 vjetorit. Imazhi i ri u pa që në përbërjen e grupit organizator. Nëse gjatë periudhës së diktaturës ishte e ndaluar edhe shikimi, kthimi i syve nga garda apo ish-blloku, këtë rradhe grupi organizator i cili përbëhej nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme të shtetit, shoqëria civile, media, dhe diplomacia e ndryshuan këtë mendim. Imazhi i ri dhe risia e këtij përvjetori ishte koncepti për të fetsuar së bashku me qytetarët të ardhur nga të gjithë trevat mbarshqiptare. Imazhi ri hyri kudo me dashamirësi - miq të mi të medias shpreheshin "Sot të gjithë ne ndjehemi Gardistë"; sot po festojmë së bashku ne dhe qytetarët shqiptarë për herë të parë pa flete-hyrje, të lirë, pa ndrojtje me motrat e vëllezërit tanë të Gardës, njëherë nga me të vjetrat në Ballkanin Perëndimor e me gjerë. Imazhit të ri i shërben edhe konceptimi dhe organizimi i muzeut, spotit, videoklipet televizive, emblemat (simbolet) dhe kartolinat me kostumet e Gardës të periudhave të ndryshme historike.

Imazhi i ri si institucion me një performancë mbresëlënëse u vu re në gjithë ambientet e Gardës, në prezantimin e administratës në aktivitetet kulturore-artistike e sportive të zhvilluara gjatë diteve të festës.

Për një imazh të ri dhe performancë bashkëkohore moderne Garda e Republikës dhe komandanti i saj Gjeneral Ndreja Prendi, kanë marrë vlerësime të herëpashershme nga personalitetet më larta të shtetit shqiptar, pershendetje dhe vlerësime nga Presidenti i SHBA Xhorxh W. Bush, si dhe nga OJF më prestigjioze në Shqipëri, kështu në dhjetor të vitit 2007 Gjeneral Prendi u lauria me cmimin: "Imazhi në Forcat e Armatosura" nga Forumi "Imazh & Media".

Imazhi dhe vizioni i ri në opinionin publik për sensibilizimin e

dijetarëve dhe shkencëtarëve për të qenë kontributor me mendimet e tyre mbi historikun e Gardës. Këtij Imazhi dhe vizioni të ri i shërbeu për herë të parë konceptimi i Simpoziumit shkencor mbajtur më 21 Qershor 2008 në ambientet e "Hotel Tirana" në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, me temë "Garda 80+ vjet". Diplomacia dhe opinioni publik ishte në ditët më të mirë organizuara. Ideimi i simpoziumit "Garda 80+ vjet" u dha mundësi hulumtuesve profesorë dhe doktorë të shkencave mos të kondisionohen në vetëm 80 vjet histori, por që nga Garda Pretoriane (mbretërore) e Skënderbeut tek Garda Mbretërore e Ahmet Zogut deri në thellësi të historisë dy mijë vjet para Krishtit tek Pellazgët, Hitët dhe Dardanët (Priam Dardani), mijera vjet më parë e deri në ditët e sotme. Pra, simpoziumi rrokte një epokë pa limit kohor, si për të kaluarën dhe historinë por edhe për vizionin, imazhin e ri për të ardhmen e Gardës së Republikës drejt një Garde Kombëtare, me përkushtim, atdhedashuri, dinjitet, fisnikëri, humanizëm e solidaritet për një performancë perëndimore të cilën e ka arritur deri tani në mënyrën më të mirë të mundshme.

Imazhi, vizioni, performanca, historiku, tradita, heroizmi, arritjet dhe objektivat e Gardës u prezantuan për ditë të tëra në median audiovizive dhe të shkruar nga Komandanti i Gardës Gjeneral Ndreja Prendi dhe departamenti publik. Gjithçka në vendin dhe kohën e duhur në një manifestim ku merrnin pjesë përfaqësues të të gjitha subjekteve politike, diplomatë të huaj, atashe ushtarak, ambasadore, ushtarake shqiptare, ish Komandantë të Gardës, ish gardistë e familjarë të tyre, si dhe qytetarë të rinj e të vjetër të cilët panë një imazh të ri të prekshëm dhe modern të Gardës së Republikës.

Të gjithë ata që ndihmuan në festimet e 80 vjetorit të Gardës së Republikës duhet të ndjehen krenar dhe progresivë. Energjia e tyre pozitive do të jetë gur themeli në performancën e njërit nga institucionet më të rëndësishme të shtetit dhe kombit shqiptar në tërësi, pas këtij tranzicioni të gjatë që kaloi Shqipëria. Sfidat për të ardhmen të këtij institucioni do të arrihen me kontributin e të gjithëve, të personelit të Gardës në rradhë të parë, shoqërisë civile, medias, OJF-ve dhe opinionit publik e qytetar.

Të gjithë së bashku për një vizion të ri, për një performancë perëndimore, për një imazh të ri, për një Gardë Kombëtare në Shqipërinë Evropiane, Euroatlantike

Dr. Astrit MEMIA
KRYETAR I Forumit "Imazh & Media"

GARDA 80⁺...VJET

SIMPOSIUM MBI HISTORINË E GARDES

Zhvilluar më 21 Qershor 2008 në kuadër të aktiviteteve të organizuara me rastin e përveçtorit të krijimit të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Simposiumi i organizuar me rastin e 80 vjetorit të krijimit të Gardës së Republikës me hulumtime mbi historinë e Gardes që në kohët e hershme e deri tek ditët e sotme, duke përshkruar historinë që nga Garda Pretoriane, Garda Mretnore, Garda e periullës së sistemit diktatorial dhe garda mbas vitit 90 në shoqërinë pluraliste si dhe diplomacinë e saj. Të realizuara nga studime dinjitoze me një përkushtim të vecantë nga Prof.Dr. Muharrem Dezhgiu, Prof.Dr. Valentina Duka, Prof.Dr. Elmaz Leci dhe studiues i diplomacisë Z. Ramiz Lushaj.

Në këtë simposium të ideuar nga Komandanti i Gardës Gjeneral Ndreja Prendi morën pjesë: Ministri i Brendshëm Z. Bujar Nishani, përfaqësues nga Presidenca, përfaqësues nga Kryeministria, përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucione të tjera shtetërore, ish Ministra të Brendshëm, ish Komandantë të Gardës së Republikës, drejtues të Gardës, si dhe përfaqësues të mediave

Komandanti i Gardës duke përshëndetur të pranishmit dhe lektorët profesor- doktorë të nderuar për punën e vyer që ata kanë bërë në hulumtimin e arkivave për të nxjerrë sa më shumë nga historia Gardës e cila sot njeh si datë zyrtare të krijimit 24 Qershorin e vitit 1928, ai shprehet se: “Vetë garda sot është përvojë e vazhdueshme e të gjithë brezave për ndryshim, kjo përpjekje për ndryshim ka bërë që Garda sot vjen në

dyshim të gjithë ata që shërbyen në këtë institucion. Kontributi i mijërave që nga koha e krijimit të Saj e deri në ditët e sotme është padyshim një vlerë jo vetëm historike por është një vlerë e mënyrës së veprimtarisë dhe të funksionimit të shtetit shqiptar.

Ministri i Brendshëm me këtë rast la dhe detyra duke theksuar :

I nxitur nga kumtesat që dëgjova e natyrisht që analizat e njerezve të historisë ngjallin debate sepse i referohen historisë dhe historia ka pasur dinamika të ndryshme zhvillimi. Unë personalisht do ta shikoja Gardën e Republikeë sot jo një pjesë e Forcës së Armatosur sesa një strukturë që ka mobilitet por që duhet të ketë një mobilitet të



80 vjetorin e saj si një strukturë e konsoliduar dhe e reformuar, si dhe me ndryshime reale në infrastrukturë.” Ministri Nishani vlerëson këtë aktivitet kaq të rëndësishëm: E kam për kënaqësi dhe për nder të marr pjesë në këtë simposium dhe në çdo aktivitet tjetër që kujton por dhe vlerëson veprimtarinë e një institucioni i cili i ka kontribuar vendit, i ka kontribuar sigurisë, ligjit dhe kushtetutës të këtij vendi. Në këtë 80 vjetor, në këte rrugë kanë kontribuar dhe duhet të vlerësohen pa

nevojshëm për detyrat dhe sfidat që ka sot Garda e Republikës. Mobilitet në tokë, ajër dhe det. Pikërisht do të nxisja drejtuesit e Gardës së Republikës, të gjithë ata që punojnë me planifikimin operacional, por edhe të gjithë ata që kanë shërbyer dhe që kanë barrë me eksperiencë nga sfidat dhe detyrat që ka kryer Garda e Republikës, që të hedhim mendime, të debatojmë dhe të prezantojmë pse jo aspektet e rëndësishme se ku, në çfarë drejtimi, në çfarë sensi duhet të modernizohet sot Garda e Republikës, për tu pajisur me mjete dhe teknologji.

Në përfundim të fjalës së Tij Ministri i Brendshëm uroi edhe më shumë vitë për Gardën e Republikës dhe suksese në realizimin e detyrave.

Në një mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur pjesëmarrësit patën rastin të ndjekin referate nga temat të cilat ndërtoan këtë simposium që hapi gjithashtu rrugën për të bërë diçka më shumë në konsolidimin e Gardës së Republikës si një strukturë e veçantë e Ministrisë së Brendshme duke treguar intelektualizën dhe kulturë me koncepte bashkëkohore.

NGA “GARDA PRETORIANE” E SKËNDERBEUT TEK “GARDA MBRETËRORE” E AHMET ZOGUT



Në kuptimin e mirëfilltë historik koncepti “gardë” ka të bëjë me një repart të posaçëm, në strukturat e ushtrisë, që përbëhet nga forca të zgjedhura, të cilët kanë si mision të ruajnë a të mbrojnë udhëheqësit a drejtuesit më të lartë politik të një shteti. Gjithashtu, forcat e saj janë të destinuara të kryejnë misionin e nderimit të shtetit me rastin e pritjes ose të përcjelljes së autoriteteve të larta shtetërore të vendeve të tjera me të cilat zhvillohen marrëdhënie shtetërore.

Aktualisht, sipas strukturës piramidale të Forcave të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, të përcaktuar nga ligji organik i saj, i datës 24 qershor 1928, është pranuar kjo ditë si data e krijimit të Gardës së Republikës. Sigurisht, vendimi që përcakton këtë datë të krijimit të Gardës së Republikës ka marrë në konsideratë lindjen dhe zhvillimin e shtetit shqiptar dhe të ushtrisë kombëtare, si armë e ruajtjes së tij.

Kështu, krijimi i shtetit të përqendruar të Skënderbeut na sjell ndërmend emërtimin “Garda pretoriane”. Garda mbretërore, siç thuhej ndryshe tek historiografët e Skënderbeut, kreu misionin e vet historik në mbrojtje të udhëheqësit më të lartë politik e ushtarak të shtetit shqiptar të shek. XV. Por, në të njëjtën kohë i dha dinjitet e madhështi Heroit tonë Kombëtar në marrëdhëniet me shtete të fuqishme të kohës, në pritjet dhe përcjelljet e personaliteteve të larta të atyre shteteve.

Në këtë kuptim tek përvoja e Gardës Skënderbegiane të shek. XV mund të kërkohej rrënjët e Gardës, në kuptimin e sotëm të kësaj fjale dhe të këtij organizimi.

Në periudhën historike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare që përbën një periudhë të lavdishme të qëndresës dhe të luftës çlirimtare të shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane, lindi Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ajo përfaqësonte të parën organizatë politike-ushtarake mbarëkombëtare me një platformë të qartë kombëtare, për një organizim shtetëror në shkallë kombëtare por dhe me një ushtri të saj.

Në Qeverinë Provizore, të dalë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, midis strukturave ushtarake të organizuara në korpuse, brigada e regjimente, do të zinte vendin e vet dhe formacioni i vogël, i quajtur gardë, e cila kishte si mision të mirëfilltë “Ruajtjen e Qeverisë Provizore”. Kjo nënkuptonte garantimin dhe sigurimin e jetës së qeveritarëve qëndrorë e lokalë.

Me ndërprerjen e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për rrjedhojë të shpërbërjes së organizmave të larta që krijoi ajo, pushuan së funksionuari edhe trupat speciale, si pjesë e Forcave të Armatosura të Lidhjes. Megjithatë, mbrojtja e personaliteteve drejtuese të administratës civile e ushtarake vazhdoi edhe më pas, por si pjesë e strukturave të Perandorisë. Këtë dukuri e konstatoi dhe e vuri në dukje edhe misionarja angleze Edith Durhami.

Qeveria e Përkohshme e Vlorës, veç të tjerave, ka meritën se ideoi dhe realizoi praktikisht struktura që kishin të bënin me mbrojtjen dhe sigurimin kombëtar. Formimi i Dikasterit të Luftës ishte tepër i rëndësishëm. Ky dikaster do të kryente dhe detyrat e Komandës së Përgjithshme të Fuqive të Armatosura, në përbërjen e të cilës përfshihej dhe Garda Ushtarake Nderi. Që kur Ismail Qemali udhëtonte nga Durrësi për në Vlorë, më 23 nëntor 1912, ai përcillej nga një Gardë Ushtarake Nderi, e cila ruante atë Burrë Shteti dhe e bashkëshoqëronte në rrugën drejt Vlorës. Ky formacion që shoqëronte Ismail Qemalin me funksionet që kreu, shpalosi elementët thelbësorë të funksioneve të Gardës, jo vetëm të ruajtjes por dhe të kryerjes së ceremonialit të Nderit në marrëdhëniet që do të krijonte Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Truproja personale, e zgjedhur për aftësitë e mira fizike dhe për besnikërinë e lartë, kishte bërë të mundur që Ismail Qemali të kryente misionin historik kombëtar dhe njëherazi t’i tregonte botës se Qeveria shqiptare ishte serioze dhe në pikëpamje të ceremonialit.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore organet e larta shtetërore të Shqipërisë dolën si rezultat i Kongresit Kombëtar të Lushnjës. Me krijimin e këtij shteti të ri prania e gardës bëhet disi më e qartë. Ky problem erdhi duke u qartësuar e duke u përmirësuar edhe në vitet e luftës politike 1921-1924. Në këtë periudhë kohore spikati roli i Ahmet Zogut me mendimet që dha lidhur me cilësitë e kriteret që do të përmbushnin pjestarët e Gardës. Ndërsa, në një dokument zyrtar të datës 15 prill 1925, vihej shumë qartë në dukje se, për ruajtjen personale të Presidentit si dhe për organizimin e ritualeve formale shtetërore, që i përkasin Kryetarit të Republikës, u formua Kompania e Gardës Presidenciale. Komandant i saj ishte toger Hysen Selmani. Në përbërje të saj ishin 17 oficerë e nënoficerë dhe 169 xhandar. Në vitet 1926-1927 batalioni i Gardës Presidenciale përbëhej nga 25 oficerë, 106 nënoficerë dhe 488 ushtarë. Ndërsa Banda Presidenciale përbëhej prej civilëve që arrinin 54 vetë. Brenda vitit 1925 u krijua dhe Adjutantura e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, e cila ngarkohej me detyrën e kontrollimit të kryerjes së shërbimit të ruajtjes nga Kompania e Gardës. Me krijimin e kësaj strukture të plotë, me detyra të përcaktuara qartë, ku spikat roli i Presidentit të Republikës, Ahmet Zogu, mund të thuhet se Garda e Shqipërisë u krijua, duke u mbështetur në përvojën më të mirë të organizimit të shtetit modern të kohës si dhe në traditën shqiptare për ruajtjen e personaliteteve.

Uniforma e gardistit dallohej nga elementë e simbole të mirëfillta shqiptare, siç ishte shqiponja e zezë dykrenore, apo shiriti kuq e zi, elemente këto, që rritnin përgjegjësinë për kryerjen e detyrës, por ngrinin lart dinjitetin dhe autoritetin e figurës së tyre, në ansamblin e Forcave të Armatosura.

Në kuadrin e përsosjes dhe forcimit të shtetit shqiptar, më 1 shtator 1928, Shqipëria u shpall “Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe e trashëgueshme”. Këtë vendim e mori Asambleja e Dytë Kushtetuese. Sipas këtij vendimi, Presidenti i Republikës, njëherësh dhe kryetari i qeverisë, u deklarua “Mbret i shqiptarëve”. Ndryshimi i formës së regjimit, duke mbetur në krye i njëjti personalitet politik, Ahmet Zogu, do të rriste më tej dinjitetin e këtij shteti në raportet ndërkombëtare. Garda, që tashmë mori cilësimin “Garda Mbretërore”, kishte këtë strukturë: Komanda e Gardës, një kompani, një eskadron kavalerie dhe banda muzikore.

Prof. Dr. Muharrem DEZHGIU

NJË VËSHTRIM I HISTORISË SË GARDËS NË VITET 1945-1990



Pas instalimit të regjimit komunist, ky i fundit ngriti nga e para të gjitha institucionet dhe organet shtetërore, të cilat kishin si qëllim kryesor ushtrimin e pushtetit dhe mbrojtien e

tij. Një pjesë e këtyre institucioneve dhe organeve ekzekutive ishin ngritur prej komunistëve dhe forcave partizane që gjatë luftës, pikërisht në këtë grup institucionesh bën pjesë edhe

garda, e cila ashtu si edhe ushtria shqiptare e pas vitit 1944 u ngrit duke patur si themel njësitë partizane të kohës së luftës.

Në këtë mënyrë “Batalioni i Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm” të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, të cilit i ishte ngarkuar detyra e ruajtjes së kërreëve të Shtabit gjatë kohës së luftës, pas çlirimit të vendit, në muajt e parë të vitit 1945, u riemërtua “Batalioni Special i Shtabit të Përgjithshëm” dhe ishte pjesë përbërëse e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Dy vjet më vonë dhe pikërisht në shkurt të vitit 1947, ky batalion do të merrte përfundimisht emrin “Garda e Republikës”. Regjimi komunist shpalli si datë të krijimit të Gardës së Republikës së Shqipërisë 12 shkurtin e 1944-ës, e cila përkonte me ditën e krijimit të kompanisë gardiste për ruajtjen e Shtabit të Përgjithshëm të LANÇ-it, datë që mbeti në fuqi deri në 6 dhjetor të vitit 1993. Garda e Republikës do të qëndronte nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes deri në vitin 1951, vit kur do të kalonte nën varësinë e Ministrisë së Brendshme. Në vitet e para të çlirimit, nisur nga rrethanat e brendshme tejet delikate si dhe nga ato të jashtme që përkojnë me fillimin e Luftës së Ftohtë, arma e gardës do të merrte një rëndësi tejet të madhe për regjimin komunist. Më pas izolimi i Shqipërisë, fillimisht nga Perëndimi dhe më pas edhe nga Lindja, do ta shtrëngonte regjimin komunist që të mbante në këmbë struktura tepër të fuqishme e të mëdha të Mbrojtjes dhe të Sigurimit, ndër të cilat arma e Gardës do të kishte një vend kyç.

Duhet theksuar se Garda ka pësuar gjatë viteve 1945–1990 një evoluim të vazhdueshëm dhe ndryshime të shumta, të cilat janë kushtëzuar si nga nevojat e rritjes së efektivitetit dhe aftësisë vepruese të saj, ashtu edhe nga zhvillimet politike të brendshme dhe të jashtme, në të cilat u përfshi regjimi komunist shqiptar.

Duke nisur nga viti 1949 në shërbim të Gardës së Republikës me vendim të qeverisë komuniste do të hynin ushtarë që vinin nga rekrutimi i detyrueshëm ushtarak. Por përzgjedhja e rekrutëve bëhej jo vetëm mbi bazën e aftësive fizike e mendore por edhe mbi atë të prejardhjes familjare. Ushtarët e Gardës duhet t’iu përkisnin familje komuniste me bënënikëri të dëshmuar në kohë ndaj regjimit, kriter i cili do të përbënte rregullin kryesor të përzgjedhjes së ushtarëve që do të shërbenin në radhët e Gardës së Republikës. Në këto kushte, pavarësisht prejardhjes familjare, regjimi komunist e pa të nevojshme që përveç procesit të ngjeshur stërvitor të përgatitjes së ushtarëve të Gardës, i cili synonte t’i aftësonte ata në shkallën e duhur për të kryer me profesionalizëm detyrën tejet delikate që u ishte ngarkuar, t’i indoktrinonte ata në mënyrë të skajshme që të mund të kishin një bënënikëri të pakufijëshme ndaj regjimit dhe sidomos ndaj kërreëve të tij. Motivi që udhëhoqi gardën tonë në periudhën

mes viteve 1945–1990, e cila shprehte mbi të gjitha kodin e tyre moral ishte: “Jemi në shërbim të Popullit, të Atdheut deri në pafundësi me çdo sakrificë!”

Në fillim të viteve ’50, në radhët e Gardës hyjnë në shërbim oficerë me një përvojë edhe më të madhe organizative dhe ushtarake. Kjo vihet re veçanërisht në radhët e drejtuesve të institucionit. Por edhe këta kadro vazhdonin të vinin nga radhët e ish-partizanëve, të cilët në mjaft raste ishin njohur personaisht qysh gjatë viteve të luftës me kërreë komunistë shqiptarë jetën e të cilëve siguronin, dhe për rrjedhojë bënënikëria e tyre ndaj regjimit ishte e plotë. Përvoja e së kaluarës u ndërthur me atë të grumbulluar nga përvoja e vendeve të tjera ish komuniste, e cila u thith prej oficerëve shqiptarë të arsimuar në akademitë ushtarake të këtyre vendeve. Duhet përmendur gjithashtu se cilësitë morale dhe trimëria e oficerëve përbënin një kusht tjetër të domosdoshëm për përfshirjen e tyre në radhët e trupave të Gardës.

Garda do të pësonte ndryshime të mëtejshme domethënëse në 1968–ën, vit gjatë të cilit Bashkimi Sovjetik sulmoi Çekoslovakinë. Denoncimi i këtij sulmi dhe i Traktatit të Varshavës prej shtetit komunist shqiptar, si dhe frika e kërreëve të regjimit komunist se mos Shqipëria pësonte një sulm të ngjashëm, çuan si në zgjerimin ashtu edhe në ndryshime të ndjeshme strukturore të Gardës. Në këtë periudhë kjo e fundit jo vetëm që u riorganizua por edhe u pasurua me një shumëllojshmëri më të madhe armësh. Kështu, numri i batalioneve të këmbësores së shtua nga një në tre të tillë. Gjithashtu, kishte edhe katër batalione këmbësoire të tjerë rezervistë, të cilët i kishin bazat në Cakran të Ferit, Lozhan të Korçës, në Mëlovë të Skraparit dhe në Mullet të Tiranës. Gjithashtu, Garda kishte tashmë njësi të saj të përherëshme jo vetëm në Durrës, Vlorë dhe Pogradec, por gjatë kësaj kohe ajo krijoi të tilla posta edhe në Korçë dhe Lezhë. Po në këtë periudhë në përbërje të Gardës futet edhe Komanda e Artilerisë si dhe shërbimet e kimisë dhe xhenjos. Garda morri më shumë formën e një brigade se sa të një batalioni. Në vitin 1976, emërtimi i Gardës ndryshon në përputhje me ndryshimin e emërimit të shtetit shqiptar, të vendosur prej Kushtetutës së vitit 1976, vit kur ajo u emërtua me emrin e ri “Garda e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.”

Garda do të ruante me fanatizëm strukturën e saj deri në vitin 1982, kohë në të cilën ajo pëson një riorganizim të ri, i cili ishte produkt i luftës së dhunshme politike që zhvillohej në gjirin e udhëheqjes së lartë komuniste dhe frikës që ngjallte tek ata dërgimi i bandave diversive nga jashtë vendit, qëllimi i të cilave ishte eliminimi i kërreëve kryesorë të regjimit, me qëllim përmbysjen e këtij të fundit. Ky riorganizim çoi jo vetëm në rritjen e numrit fizik të gardistëve por edhe në pasurimin e gardës me armatime të reja dhe më moderne. Gjithashtu u zbatuan plane për ndërthurjen dhe bashkërendimin e punës së saj me organe, reparte dhe njësi të tjera të Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Mbrojtjes. Duhet theksuar gjithashtu se Garda ka pasur grupin e saj artistik dhe atë sportiv, Për shërbimet e kryera, ajo u dekorua në 12 shkurt të vitit 1984 me Urdhrin e Flamurit. Garda gjithashtu përfaqësonte strukturat më fanatike dhe konservatore të sistemit komunist dhe ishte një ndër institucionet e atij sistemi që nuhati e fundit aromën e ndryshimeve demokratike në fillim të viteve 90.

GARDA E REPUBLIKËS NË VITET E SHOQËRISË PLURALISTE



Ndryshimet demokratike ne Shqiperi pas zgjedhjeve te 22 marsit 1992, e gjeten Gardën e Republikës me struktura te vjeteruara dhe me moral te ulet. Ajo trashegonte nje disipline krejt formale, nje efektiv te renduar dhe mjaft te shperndare.

Ne kushtet e reja qe u krijuan, duhej reformuar edhe Garda. Ne nje shtet si yni, me territor te vogel, me potencjal ekonomik dhe njerzor te kufizuar, mbajtja e

nje force gardiste te madhe, te jparametrave dhe koncepteve te ndryshuara ne klimen e krijuar te periudhes se pas Luftes se Ftohte, perbente nje ngarkese te rendë per vendin, qe ndikonte drejtpersedrejti, si ne nivelin e mirqenies se vete popullit ashtu edhe te ushtarakeve. Kjo arrihej me nje rikonceptim te misionit dhe te detyrave. Struktura ekzistuese e Gardes, ne gjendjen qe e gjeti fitorja e demokracise, vec shpenzimeve te medha ekonomike, nuk siguronte as zgjidhje efektive te detyrave ushtarake, pasi ajo kishte edhe nje shperndarje te panevojshme, gje qe i kishte anagazhuar trupat kryesisht ne roje objektesh, duke i larguar ato nga misioni kryesor-sigurimi i jetes se personaliteve. Ne kushtet e reja qe krijoi demokracia ne Shqiperi, reformimi i strukturave ushtarake te ish Ministrise se Brendeshme, pra edhe i Gardes, ishte nje detyre imediate dhe u be imperativ i kohes. Per te kryer kete reformim, Qeveria Demokratike perplloi edhe programin per reformimin konceptual e strukturor te Gardes. Garda perballe riorganizimit dhe një misioni të ri. Proceset e gjithanëshme demokratizuese që përfshinë Shqipërinë e viteve '90-të, natyrshëm përfshinë Ministrinë e Brendëshme, atë të Mbrojtjes, por edhe Gardën e Republikës, pra te gjitha Forcat e Armatosura. Kështu, si Datë krijimi për Gardën e Republikës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me Vendimin Nr. 562, datë 06.12.1993, gjykoj dhe vendosi që tashmë të jetë 24 qershori vitit 1928, dhe jo më 12 Shkurt 1944, datë e cila ishte mbajtur për gati pesëdhjetë vjet.

Data e Re, lidhet me Dekret-Ligjin e Qeverisë Shqiptare të kohës, kur për herë të parë në Historinë e Ushtres Kombëtare dhe të Gjindarmërisë Shqiptare jepet një ligj organik, mbi bazën e të cilit bëhet organizimi i tyre. Vendimi i Qeverisë Shqiptare përbën një akt të rëndësishëm, sepse së paku synohet rivlerësimi i historisë sa më pranë realiteteve, duke iu larguar politizimit shterp. Në këtë mënyrë Garda do të kishte një datë krijimi bazur në fakte e dokumente historike autentike, do të kishte një rrugë të gjatë në të cilën ka ecur e ka lënë gjurmë, një përvojë e veprimitari të gjerë, të pasur e të çmuar, e cila ndërthen edhe vlera krenarie kombëtare dhe duhet vlerësuar e reflektuar pozitivisht. Njëherësh kjo përbën edhe një homazh e vlerësim të punës së dhjetra-qindr shtetarëve e ushtarakëve shqiptarë, të cilët ëndërruan dhe punuan për krijimin dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptar me gjitha institucionet dhe instrumentet e nevojëshme, përfshi edhe të formacionit special, siç është Garda. Ky ishte edhe një akt i lartë atdhetar e moral, ku vlerësohet jo shumë në thellësinë e shekujve por më afër, puna e vepra atdhetare e gjithë atyre, të cilët realizuan 28 Nëntorin e vitit 1912, një nga ditët më të çmuara në historinë e Kombit Shqiptar, duke e shpallur vendin të Pavarur.

Ligji, dimensionet e reja misioni për Gardën

Veprimtaria dhe aktiviteti i Gardës së Republikës u gjykua të organizohet e të kryhet mbi bazën e Paketës Kushtetuese, e miratuar në vitin 1991 me fuqi vepruese deri sa të miratohet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të Vendimeve të Këshillit të Ministrave e të akteve nënligjore të dërguara nga

Ministria e Brendëshme apo e Rendit Publik (në harkun kohor 1991-1998 dhe më vonë, pothuajse sa herë janë krijuar kabinete qeveritare, ka ndryshuar edhe emërtimi i kësaj Ministrise), si dhe të përcaktimeve që bëhen në Rregulloren e Brendëshme të Gardës së Republikës dhe të urdhërave të tjera të titullarëve të institucionit prej nga varet ajo. Me miratimin e Kushtetutës së Re të Republikës së Shqipërisë, dekretuar më 28 Nëntor 1998, veprimtaria e Gardës së Republikës do të kishte në themel dhe në bazë pikërisht këtë Ligj Themeltar. Efektet e këtij ligji nuk do të vononin të ndiheshin. Jo shumë kohë pas ndryshimeve të thella të realizuara në vitet '90-të, Kuvendi Popullor (Parlamenti) i Republikës së Shqipërisë, me Vendimin Nr. 7602 dt. 09.09.1992, miratoi ligjin "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", ashtu si Presidenti i Republikës dekretoi këtë ligj, pra e bëri publik dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar, me Dekretin Nr. 322, dt. 15.10.1992.

Statusi i ri, domosdoshmeri per funksionimin e ardhshem Gjatë periudhës postkomuniste Garda e Shqipërisë dy herë është pajisur me ligj specifik, i cili përcakton misionin, organizimin dhe statusin e saj. I pari i përket vitit 1992, për të cilin u shprehëm më sipër, ndërsa i dyti mban nr. 8869 dt. 22.05.2003. Në të dy rastet ai është emërtuar "Ligj për Gardën e Republikës së Shqipërisë", por duhet pohuar se ka dallime jo vetëm në numrin e neneve (i pari me 16 të tillë, ndërsa i dyti me 44), por sidomos në përmbajtje për problemin e misionit, mënyrën e përmbushjes së tij, etj., etj. Kështu, ndërsa i pari nuk e cik thau fare çështjen e përmirësimit të "Shëndetit Psikologjik", i dyti e nënvizon me mjaft theksime. Mbrojtja juridike e punonjësit të Gardës, të familjes dhe të pronës së tij, në formë e në përmbajtje, në këtë ligj duket se është mëse e mjaftueshme, kur gjykojmë se gardisti cilësohet "person juridik i paprekshëm" qoftë në shërbim apo për shkak të tij, apo kur ai "autorizohet" nga ligji që të përdorë forcën fizike ose mjete teknike të posaçme për të neutralizuar ose për të shmangur ata që nuk i binden kërkesave të tij gjatë kryerjes së shërbimit që



vjen nga misioni i tij juridik. Përmes pesë neneve drejtpersedrejti punonjësi i Gardës trajtohet me përparësi në marrëdhëniet me institucionet e tjera të shtetit dhe me subjektet private.

Kisurse mund të gjykohej, ligji më i fundit "Për Gardën e Republikës" është mjaft i prekshtëm juridikisht, financiarisht dhe moralisht prej punonjësve të Gardës. Kjo gjithësesi mbetet një mundësi më tepër për motivimin dhe nxitjen në sensin pozitiv për përmbushjen e detyrës me bindshmëri, me këmbëngulje, me devocion. Ky ligj jo vetëm detyron, por edhe motivon në kryerjen e detyrave; jo vetëm ve detyra dhe kërkon

Prof. Dr. Kol(R) Elmas LEÇI
Rektor Universitetit Ushtarak "Skenderbej"

TRADITA GARDISTE SHQIPTARE NË RRJEDHAT E HISTORISË



Tradita gradiste i ka fillesat e veta mijërvjeçare, që në ndarjen e ngritjen politiko-ekonomike-ushtarake të fiseve të ndryshme, por organizimin e saj strukturor, në nivelet e kohës, në mënyrë të dokumentuar, e gjemë rreth 2 mijë vjet para Krishtit në hapësirat e Mesdheut, sidomos tek Pellazgët, Hititët, etj. Fiset pellazge, (proto-ilirët), me një kulturë 10 mijë vjeçare në të gjitha fushat e dijes e veprimtarisë, aty nga shek. XII-XIII para Krishtit, sipas Homerit të Madh, etj., morën pjesë në Luftën e Trojës, ku prijësit e tyre, përveç ushtrisë së mobilizuar, mbanin edhe gardën e vet të përhershme, siç përmendet rasti i Priam Dardanit, etj. Mbretëria Hitite, me shtrirje të asokohshme në hapësira të gjëra të Lindjes së Mesme, që në vitin 1680 para Krishtit, dinastitë mbretërore të saj, mbanin gardën e tyre me truproja të specializuara. Në Egjipt, në vitin 1274, në kohën e Ramesit II, garda kishte deri në 5.000 – 6.000 vetë. Dinastia Kineze, Tang, në vitin 617 para Krishtit, kishte rreth 30 mijë trupa gardiste, ndërkohë që thirrmin në luftëra deri në 200 mijë luftëtarë. Persët, në vitet 547 – 479 para Krishtit, mbanin një gardë elitare deri në 10 mijë vetë, ndërsa në kohën e Shahut të Iranit, më 1978, kishte një gardë perandorake me 4.000 – 5.000 trupa, duke përfshirë edhe një batalion tankesh.

Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, mbante një gardë të përzgjedhur për në Kalanë e Krujës apo në udhëtimet brenda e jashtë vendit ose në luftërat e tij kur ishin masive e ballore, biles Garda Pretoriane (Mbretërore) e Skënderbeut, në janar 1468, shkoi në betejë pa Kryetrimin e vet. Në kohën e sundimit Otoman, Porta e Lartë në Stamboll, (por edhe pashallarët shqiptarë në Trojet Tona Etnike apo në vendet të tjera të kësaj perandorie), kishte një numër të madh shqiptarësh (arbnorë), që shërbenin në Gardën e Sulltanit dhe quheshin “çauş”. Gardat më të fuqishme i kishin pashalleqet e Bushatllinjëve e Ali Pashë Tepelenës, dinastia shqiptare në Egjipt, etj.

Gardë, në kohë të kufizuar, kanë pasë edhe disa udhëheqës të pendës e luftës, si Arqipeshki i Shkupit, Pjetër Bogdani, i cili punoi shumë për organizimin e rezistencës antiosmane gjatë Luftës Austriako-Otomane. Në nëntor 1689, kur austriakët hynë në Prishtinë, Bogdani mobilizoi edhe 6.000 luftëtarë shqiptarë në Prizren duke u shkuar në ndihmë austriakëve. Në Gardën e tij, sipas përvojës austriake, kishte rreth 200 shqiptarë trima e besnikë, por në dhjetor u sëmurë nga mortaja dhe vdiq dhe, pas thyerjes së austriakëve, tatarët dhe turqit e nxjerrin nga varri trupin e tij, ku rezistuan ish-gardistë të tij kundër këtij veprimi antinjerëzor, duke dhënë edhe jetën e vet.

Plaku i Vlorës, Ismail Qemali, bashkë me patriotë si Luigj Gurakuqi, në rrugëtimin e tij diplomatik për Pavarësinë Kombëtare Shqiptare, kur arriti në Bukuresht, më 3 nëntor 1912, kishte 8 truproja shqiptare me vete, ndërsa më 5 nëntor, në hotelin “Kontinental” të këtij kryeqyteti, përveç 4 përfaqësuesëve të kolonisë shqiptare të Rumanisë, iu shtuan edhe 6 truproje të tjera për sigurinë e tij dhe të delegacionit. Në udhëtimin e tij nga Vjena (7 e 10-11 nëntor), në Budapest (8-9 nëntor), Itali (18 nëntor), teksa arriti në Durrës, me vaporin austriak “Baron Bruck” më 19 nëntor 1912, që në ditën e parë, i pati rreth 50 truproja vullnetare.

Si datëlindje e Gardës së Republikës, tashmë njihet e sanksionuar zyrtarisht 24 qershori i vitit 1928, duke u marrë si pikënisje e eveniment Dekret-Ligji mbi strukturën e Forcave të Armatosura, ku përfshihej edhe Garda e Republikës, që rreth dy muaj më vonë u cilësua “Garda Mbretërore Shqiptare”. Me këtë akt zyrtar të datëlindjes së Gardës të Republikës u hodh një hap i mirë, sepse kjo kishte mbetur padrejtësisht tek 12 shkurti 1944, 16 vjet më vonë dhe e caktuar nga forca politike, që donte të bënte historinë e vet. Por, në kuadrin e rivështrimit e rishkrimit të historisë tonë kombëtare, vëmendja e studiuesëve duhet të kërkojnë edhe më herët.

E rëndësishme është se në këto 80 vite, Garda u krijua, organizua e konsolidua në nivele të larta bashkëkohore, pamvarësisht nga format e organizimit të Shtetit, duke treguar një devotshmëri të lartë atdhetare, një profesionalizëm modern, një kontribut mirënjohës. Garda e Republikës, e dekoruar me “Medaljen e Artë të Shqiponjës” (1998) dhe komandanti i saj, kolonel Ndreja Prendi, në dhjetor 2007, i vlerësuar me Çmimin “Imazhi në Forcat e Armatosura”, tregojnë se kemi të bëjmë me përkushtim të admirueshëm në misionin shtetëror e qytetar të saj.

Studiues, Ramiz LUSHAJ

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara me rastin e 80 vjetorit të Gardës së Republikës një punë e madhe është bërë edhe nga ana mediatike e promovimit të Gardës në këtë përvjetor.

U realizuan; albumi fotografik **“80 Vjet”**, materialet e hulumtuesve të historikut të Gardës në Shqip dhe Anglisht, kartolina publicitare me uniformat e Gardës ndë vite me një kuti me spilë dhe përmbante 8 llojet e ndryshme të uniformave të cilat iu dhuruan pjesëmarrësve në këtë ceremoni.



“Garda 80 Vjet”

Ceremonia e 80 vjetorit te krijimit te Gardes se Republikes se Shqiperise 24 Qershor 2008



Garda e Republikës së Shqipërisë më 24 Qershor 2008 mbushi 80 vjet. Në këtë udhëtim të gjatë historia e Gardës ka qenë shpeshërë e fshehur duke mos vënë në dukje vlerat aq të mëdha të misionit të Saj fisnik. Ajo u krijua më 24 Qershor 1928 dhe u quajt Garda Mretnore.

Sot më e plotë së asnjëherë më parë Garda e Republikës ka shpalosur të gjithë arsenalin e Saj profesional për të treguar se ajo i ka rrënjët tek historia e shtetit dhe e popullit shqiptar. Në këtë 80 vjetor Garda vjen me një performancë të pranueshme duke kaluar një sërë ndryshimesh dhe reformash profesionale, ku parimi bazë është konkurrenca për të ecur përpara duke arritur objektivat me sukses dhe në kohën e duhur. Përgatitje e lartë profesionale e punonjesve Gardistë të cilët me punën e tyre të vazhdueshme stervitore po arrijne pa dyshim standardet ndërkombëtare në kryerjen e detyrave, duke përmbushur me sukses misionin e Gardës së Republikës në **“Ruajtjen dhe mbrojtjen e Personalitetve të larta Shtetërore, të vendit e të huaja që vizitojnë vendin tonë, si dhe selive e residencave të përcaktuara me ligj”**. Në këtë përvjetor Jubilar angazhimi i plotë i strukturave të Gardës së Republikës nën

drejtimin e Komandantit të Gardes Gjeneral Ndreja Prendi solli një mentalitet të ri në mënyrën e konceptimit të organizimit të aktiviteteve në kuadër të 80 vjetorit të krijimit të Saj.

Në këtë ditë të shënuar nderuan me pjesëmarrjen e tyre: Presidenti i Republikës së Shqipërisë Z. Bamir Topi, N/kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Fatos Beja, Ministri i Brendshëm Z. Bujar Nishani, Ministri i Mbrojtjes Z. Gazmend Oketa, Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës Z. Genc Ruli, Ministri i Bujqësisë Z. Jemin Xhana, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale Z. Kosta Barka, Deputetë, drejtues të Lartë të Institucioneve Shtetërore, Drejtues të komuniteteve Fetare, përfaqësues të trupit Diplomatik, Atashe ushtarak të akredituar në vendin tonë, ish ministra, ish Komandantë Garde, përfaqësues të Medias, ish oficerë e ish nënoficerë të Gardës, pjestarë të familjeve të oficerëve e nënoficerëve të Gardës të të rënë në krye të detyrës si dhe miq e dashamirës të Gardës së Republikës.

Për herë të parë Garda aplikoi një pritje protokollare të këtij rrangu, festimi i 80 vjetorit të krijimit të Gardës u ndërtua në dy faza.

Ceremonia zyrtare e cila filloi në orën 10:00 dhe përfundoi në orën 13:00, si dhe koncerti festiv me këngëtare, humoristë dhe valltarë.

Komandanti i Gardës në fjalën e Tij të rastit pasi përshëndet të ftuarit, citon :

“ Në të gjithë historinë e saj, pavarësisht nga ndryshimet që ka kaluar vendi Garda e Republikës ka ditur të përmbushë misionin e saj, duke shërbyer me përkushtim për sigurinë e Personelit të Larta Shtetërore të vendit dhe të huaja. Kontributi i brezave ka bërë që

- *Vlerësimi sipas gradave.*
 - *Fuqizimi i shërbimeve në bazë, duke balancuar përdorimin e burimeve njerezore dhe siguruar një bashkeveprim të drejtëpërdrejtë, të harmonizuar, ndarje të saktë të përgjegjëve, funksionimin real të sistemit të komandimit, kontrollit e komunikimit ndërmjet strukturave sipas vartësisë .*

Të gjitha këto reforma, kanë ndikuar drejtëpërsëdrejti me rritjen e cilësisë së shërbimit, për sigurinë e personaliteteve të Larta të Shtetit, si dhe kanë të mundur rritjen e



Garda sot, vjen në 80 vjetorin e krijimit të saj, si një strukturë e aftë profesionalisht, me përgjegjësi të lartë qytetare për të shërbyer atdheut me bindje të plotë në realizimin më çdo kusht të detyrave.

Sot në këtë 80 vjetor, Garda është më e konsoliduar se kurrë, puna me profesionalizëm, krijimi i mentalitetit bashkëkohor, menaxhimi me ide e projekte, funksionimi real i të gjitha hallkave të domosdoshme për realizimin e detyrës, kanë bërë të mundur realizimin e reformave në mjaft drejtime:

- *Vënia e themeleve të konkurrencës, gradë e karriere, në funksion të piramidës së gradave.*

aftësive të kuadrove për të shërbyer me profesionalizëm.”

Komandanti gjithashtu i drejtohet Presidentit të Republikës: **“I nderuar Zoti President! Në emër të strukturës që unë drejtoj, angazhohemi dhe Ju premtojmë së Garda e Republikës do të përmbush të gjitha detyrat, do të punojmë pa u lodhur, për të arritur më të mirën.”**

Në përfundim të fjalës së Tij Komandanti i Gardës Gjeneral Ndrea Prëndi uron të gjithë efektivat gëzuar 80 vjetorin e krijimit të Gardës së Republikës.



Presidenti i Republikës së Shqipërisë duke nderuar këtë 80 vjetor në fjalën e Tij thekson:

Kam kenaqesine dhe nder te veçante qe me rastin e 80 vjetorit te Gardes se Republikes se Shqiperise te pershendes me cilesine e Presidentit te Republikes dhe te Komandantit te Pergjithshem te Forcave te Armatosura te gjithë ata qe sot mbajne uniformen e nderuar te Gardes se Republikes dhe te gjithë ata qe nder vite e kane nderuar kete uniforme me perkushtim e profesionalizmin e tyre. Deshiroj qe ne kete dite te shenuar te kujtojmedhe te nderojme te gjithë se bashku ata gardiste qe kane dhene jeten duke permbushur detyren dhe misionin e tyre sa te veshtire aq edhe fisnik, ne sherbim te vendit dhe te siguroj familjaret e tyre te dashur per vleresimin dhe mbeshtetjen e shtetit shqiptar.

Sot ne kete jubile te rendesishem kam nje falenderim te veçante per te gjitha vendet mike dha aleate te cilat nder vitet e veshtira te tranzicionit shqiptar, kane mbeshtetur shderrimin e Gardes se Republikes ne nje strukture per te perballuar me sukses sfidat e reja per ndryshime te vrullshme siç ndoll ne shqiperi vitet e fundit.

Sot jemi mbledhur per te kujtuar 24 qershorin e 1928-tesdaten e krijimit te Gardes se Republikes, 80 vjet natyrisht jane shume vite pune dhe sakrificash per te vleresuar dhe evidentuar misionin e rendesishem dhe delikat te Gardes nepermjet nje analize dhe bilanciobjektiv, por jane vite te mjaftueshme per te ndertuar nje strategji dhe nje politike pershtatese ne permbushjen me sukses te tyre

ne te ardhmen. Ne domosdoshmerine e perzgjedhjes, te pergatitjes profesionale te te gjithë personelit te Gardes se Republikes dhe gjithshu proven ndaj qytetareve te Shqiperise se misioni i tyre eshte ne sherbim te vendit dhe te interesave te shtetit. Vetem nje personel thelbesisht profesional do te ndryshoje jo vetem imazhin e frikshem te trashëguar nga vitet e diktatures, por do ta beje kete strukture cilesisht te denje per te perballuar sfidat qe ka shoqeria shqiptare per rajonin dhe mbare boten.

Te dashur ushtarë, oficere e nenoficere te Gardes se Republikes Shqiperia ndollet sot me afer se kerre antaresimit te saj te plote ne NATO. Ky vleresim nga ana e partnerev e tane te aleances eshte edhe nje vleresim ndaj jush dhe misionit tuaj te deritanishem. Renditja e shqiperise perkrah vendeve te aleances me te fuqishme strategjike, politike dhe ushtarake ne bote rendit perpara jush domosdoshmerine e nje pergatitjeje cilesisht profesionale thelbesisht efikase maksimalisht te ndergjegjeshme dhe thellesisht te besueshme. Aleanca kerkon



partneritet dhe kontribute dhe ne duhet te perballemi me to.

Gesrshetimi i pervojës me energjine dhe vullnetin e brezave te rinj, japin vleren e çmuar te Gardes se Republikes per shoqerine shqiptare dhe per te ardhmen e saj.

Gezuar 80 vjetorin e Gardes se Republikes. Ju uroj nga zemra suksese ne permbushjen e detyres suaj te veshtire dhe shume fisnike.

Presidenti i Republikës me rastin e 80 vjetorit te krijimit i jep Gardes se Republikës “Medaljen e Mirenjohjes” me motivacionin “ Per arritje te rendesishme ne permbushje te detyres se Saj te veshtire dhe me pergjegjesi te larte”



Me pas dekoron me “Medajlen e Arte te Shqiponjes”, Kolonel Frank Prenga dhe Kolonel Dashamir Shehi me motivacion “Per arritjen me sukses te detyrave te veshtira dhe delikate ne sherbimin per ruajtjen dhe sigurimin e Personaliteteve te Larta”, Major Astrit Osmani dekorohet me medaljen per “Sherbime



Ushtarake” me motivacion “ Per perkushtimin dhe ndjenjen e pergjegjesise ne realizimin me sukses te detyrave ne sherbimet mbeshtetese te strukturave operative per ruajtjen dhe sigurimin e Personaliteteve te Larta” dhe N/ Kapiten Altin Kollçinaku me medaljen per “Sherbime Ushatarake” me motivacion “ Per perkushtim dhe ndjenjen e pergjegjesise ne



realizimin me sukses te detyrave te veshtira dhe delikate ne sherbimin per ruajtjen dhe sigurimin e Personaliteteve te Larta. dekoron pas vdekjes me medaljen per “Sherbime Ushtarake” Kastriot Koçi me motivacion “ Per perkushtimin e Tij dhe pergjegjesise ne realizimin me sukses te detyrave te veshtira



dhe delikate ne sherbim te ruajtjes dhe sigurimit e Personaliteteve te Larta”,

Me propozim te Kryeministrit te Shqiperise, Presidenti i Republikes dekreton Kolonel Ndrea Pjeter Prendi me detyre Komandant i Gardes se Republikes me graden Gjeneral.



Me rastin e 80 vjetorit te krijimit te Gardes se Republikes Ministri i Brendshem jep gradim te parakohshem me motivacionin “**Per pune me disipkine te larte, profesionalizem e perkushtim per realizimin e te gjitha detyrave e objektive**” per punonjesit oficere: Shqipe Spahiu, Gjergj Ndreka, Mehmet Shkreli, Fran Gjoklaj, Halil Hoxhaj, Behar Hasa, Isa Mella, Ermal Zaimaj, si dhe Nazmi Pellumbi.







Gjithashtu Komandanti i Gardes me rastin e 80 vjetorit te krijimit te Gardes se Republikes jep gradim te parakohshem me motivacionin **“Per pune me disipline te larte, profesionalizem e perkushtim per realizimin e te gjitha detyrave e objektivave”** per punonjesit n/oficere: Beqir Elezi, Ibrahim Alimetaj, Ali Dule, Ymer Keta, Kujtim Merepeza, si dhe Genc Kacanja.

Demonstrimet e Njesise Speciale te realizuara nga nje stervitje sistematike dhe pergatitje te larte profesionale, treguan nivelin e larte fizik ne shpejtesi dhe saktesi ne ushtrimet e paraqitura,



gjithashtu koordinimi mes strukturave te Gardes dhe policise se shtetit te realizuara me aq saktesi nga Dega e RM te PLSH-ve qe ne bashkeveprim me Njesine e Dyte dhe Njesine Speciale realizoi nje performance te shkelqyer te pergatitjes profesionale, psikologjike e fizike te nje niveli te larte. Keto demonstrime u ndoqen me vemendje nga pjesmarresit ne kete feste te vertete si dhe te shoqeruara nga zeri aq i njohur i gazetares Tefta Radi e cila komentoi keto demonstrime te cilat u paraqiten te pranishmeve per te treguar lartesine profesionale dhe arritjet e Gardes se Republikes ne kete 80 vjetor.



Vizita ne Muzeun e Gardes pa dyshim ishte pjese e nje skenari te pergatitur me delikatese nga grupet e punes qe organizuan kete ceremoni jubilar. Presidenti i Republikes i shoqeruar nga

kete pervejetor ishte pergatitur me seriozitet dhe profesioanlizem per te paraqitur sa me mire, ate qe ne te vertete ajo perfaqeson, qe publiku per here te pare kishte mundesine te shikoje nga afer Garden, hyrja e lire ne ambientet e Garnizonit te Gardes ishte nje element per ti treguar qytetareve qe shpesh kalonin aty se Garda mund te vizitohet dhe se ato mund te festojne se bashku ne pervjetorit e 80 te Saj.

Ne mbasditen e 24 qershorit ne vazhdim te veprimtarive te organizuara ne kuader te 80 vjetorit u zhvillua koncerti festiv "Garda 80 Vjet" me pjesmarrjen e "Ansambli Kombetar te Kengeve dhe Valleve Popullore" me prezantim te Migena Krajes, me kengetare te njohur si Eranda Libohova, Angjelika Qyfeku, Grupi Bik & Ben i



Komandanti i Gardes dhe te pranishmit, vizitoi Muzeun e Gardes duke lene nje shenim vleresimi per punen e bere ne pasqyrimin realist te historise se Gardes ne Muzeun e Saj, me pas Presidenti i Republikes i shoqeruar nga komandanti i gardes dhe te ftuarit inspektoi edhe ambientet e rikonstruktura te Njesise se pare te cilat tregojne qarte arritjet dhe permiresimet e kushteve ne ambiente per jetese, pune, sherbim dhe pushim te efektivave te Gardes se Republikes.

Ne perfundim te ceremonise u organizua nje koktej per te pranishmit. Garda e Republikes ne

perfaqesuar nga Ludovik Gjoka efektiv i Gardes, Fatmira Breçani, me humorin shume popullor te sjedhe nga umoristet Behar Mera dhe Rita Lati. Spikaten gjithashtu trio me çifteli nga oficeret e ushtare Gardiste, si dhe nje bashkepunim shum i mire midis grupit lab te ushtareve Gardiste me kengetaret e Ansambli Kombetare me kengen kushtuar 80 vjetorit te krijimit te Gardes se Republikes. Koncerti u mireprit nga spektoret e shumte qe ndolleshin ne Garde dhe shenoi gjithashtu edhe nje hap perpara per rritjen e nivelit kulturor te perfaqesuar nga Garda.

**Specialist i Marredhenieve me Publikun
Altin Prendi**



ZHVILLIMI I FAZES PERFUNDIMTARE TE IMPLEMENTIMIT TE SISTEMIT TE RI TE TRAJTIMIT PAGE-GRADE-NIVEL I FUNKSIONIT ORGANIK.



Më 01 Korrik 2006, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 16.08.2006 “Për njësimin e funksioneve organike sipas gradave në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, filloi implementimi i sistemit të ri të trajtimit, pagë-gradë-nivel i funksionit organik në zbatim të ligjit nr. 9366, datë 31.03.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Në fazën e parë, duke vlerësuar lidhjen mes formit e kualifikimit profesional-vjetërsi shërbimi aktiv-gradë-kohë e qëndrimit në një gradë, u realizua njësimi i gradës me nivelin e funksionit organik për të gjithë punonjësit oficer e nënoficer efektiv të Gardës së Republikës.

Në fazën e dytë komisionet e gradave dhe karrierës për punonjësit oficerë e nënoficerë, u përballën me procesin e gjyqimit dhe vlerësimit për përputhjen e gradës me nivelin e funksionit organik. Kjo fazë hodhi themelin dhe shënoi fillimin e procesit të konkurimit për gradë e karrierë, duke krijuar kushtet për të vënë përballë: kërkesat e punonjësve oficer e nënoficer për gradë me nevojat sipas niveleve të funksioneve organike.

Në zbatim të ligjit të gradave e karrierës në Gardën e Republikës, në Korrik 2008 përfundon afati kohor për implementimin e sistemit të ri të trajtimit financiar pagë-gradë-nivel i funksionit organik.

Me propozim të Komandantit të Gardës, Ministri i Brendshëm ka miratuar zhvillimin gjatë periudhës Qershor-Korrik 2008, të fazës përfundimtare të Implementimit të VKM nr. 553, datë 16.08.2006 “Për njësimin e funksioneve organike sipas gradave në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, implementimin e përparimit në gradë e karrierë për punonjësit oficer e nënoficer efektiv të Gardës së Republikës dhe njësimin me funksionet organike për strukturat e Gardës, si dhe procedurat administrative për zhvillimin e kësaj faze.

Qëllimi i fazës përfundimtare të implementimit të sistemit të ri të trajtimit pagë-gradë-nivel i funksionit organik, është të realizojë brenda afateve kohore të percaktuara në ligj: përputhjen e gradës me nivelin e funksionit organik, sipas Lidhjes Nr. 1 të VKM Nr.553, datë 16.08.2006.

Për zhvillimin me sukses të fazës përfundimtare, komisionet e gradave dhe karrierës për oficerë e nënoficerë, si autoritet kompetent për vlerësimin e përparimit në gradë e karrierë të punonjësve oficer e nënoficer: për të gjithë punonjësit oficer e nënoficer efektiv në Gardën e Republikës, pavarësisht nëse Ju ka lindur e drejta e kërkesës për gradën e radhës.

Vlerësimi i përparimit në gradë e karrierë do të bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në kriteret e percaktuara në Ligjin Nr. 9366, datë 31.03.2006 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe konkretisht:

- Afati kohor që i lind e drejta punonjësit të kerkojë gradën e radhës (neni 7 i ligjit)
- Afati i kohës maksimale të qëndrimit në një gradë (neni 8 i ligjit)
- Formimi e kualifikimi profesional (neni 16 i ligjit)
- Rezultatet e arritura dhe vlerësimi i punës vjetore (neni 15 i ligjit)

Gjykimi dhe vlerësimi i komisioneve do të evidentohet në proces verbalet që mbahen për këtë qëllim dhe rezultati apo vendimi i marrë me propozimin konkret evidentohet gjithashtu për secilin punonjës në Memot (relativet) të përgatitura për Komandantin e Gardës, të sigluar nga të gjithë anëtarët e komisioneve.

Për mbarëvajtjen e kësaj faze, Sektori i Burimeve Njerëzore, ka përgatitur dokumentacionin përkatës mbi procedurat e zhvillimit të kësaj faze:

- Janë evidentuar nevojat organike sipas niveleve për strukturat e Gardës.

- Bazuar në dosjet personale në Kartotekën e Personelit, janë evidentuar punonjesit oficer e neneoficer që ju lind e drejta e kërkesës për gradën e rradhës.

- Bazuar në dosjet personale në Kartotekën e Personelit, janë përgatitur relacionet mbi evidentimin me përgjegjësi të plotësimit të kritereve të përcaktuara në ligj për secilin punonjës oficer e nenoficer, për Komisionet e Gradave dhe Karrierës.

- Komandanti i Gardës ka miratuar modelin tip të përgatitjes së vlerësimit të punës dhe të personalitetit dhe në bashkëpunim me kuadrot drejtues të strukturave është punuar për të plotësuar rubrikat përkatëse për të gjithë punonjësit e vartësisë me tregues konkret për sasinë dhe cilësinë e punës, duke përdorur metodën e krahasimit midis periudhave dhe ndërmjet kuadrosh të së njëjtës detyrë, kryerjen e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore dhe qëllimet që duhet të arrihen; mbi aftësinë shprehëse e komunikuese me kolegët, eprorët, vartësit dhe publikun, mbi pastërtinë e figurës, drejtësinë e korrektësinë, aftësinë për të qenë të paanshëm në vlerësim e gjykim dhe të përkushtuar në përmbushjen e detyrës, me qëllim që sa më real e i paanshëm të jetë vlerësimi aq më e ashpër dhe i veshtirë do të jetë konkurimi.

Me përgatitjen e dokumentacionit të lartpërmendur, me propozim të Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Komandanti i Gardës, ka miratuar mbledhjen e Komisioneve të gradave e karrierës, deri më 20 Korrik 2008.

Pas gjykimit dhe vlerësimit të Komisioneve do të punohet me dokumentacionin vlerësues, për evidentimin duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj faze nën drejtimin e Komandantit të Gardës,

në mbledhjen e analizës mujore për muajin Qershor me drejtues të strukturave të Gardës së Republikës, u punua tematika mbi procedurat e zhvillimit të fazës përfundimtare të implementimit të sistemit të ri të trajtimit pagë-gradë-nivel i funksionit organik, të mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Komandanti i Gardës dha detyra për drejtuesit e strukturave që të informonin të gjithë punonjesit e vartësisë mbi bazën ligjore e procedurat e zhvillimit të kësaj faze, të punojnë për vlerësimin real të punës sipas aftësive të secilit, si dhe për Kryetarët e Komisioneve të gradave e karrierës që të merrnin të gjitha masat për mbarëvajtjen e procesit për të vlerësuar me përgjegjësi mbi përparimin në gradë e karrierë për të gjithë punonjësit oficer e nenoficer

Kjo fazë shënon fillimin e procesit të emërimit në detyrë të mbështetur në konkurimin për gradë e karrierë, duke krijuar kushtet për të vënë përballë kërkesat e punonjësve oficer e nenoficer për gradë me nevojat sipas niveleve të funksioneve organike, gjë që do ta kërkojë në konkurimin e radhës, për strukturat përgjigjëse, përgatitje të një dokumentacioni me specifik.

Për të ardhmen, për konkurimin e radhës, për një konkurim me perfaqsim dinjitoz nga punonjësit efektiv të Gardës, menjëherë pas përfundimit të kësaj faze, personeli në bashkëpunim me Shtabin e Drejtuesit e Gradës, do të planifikojnë zhvillimin e kurseve të kualifikimit profesional, kurse për gradën e karrierës në përputhje me ligjin e gradave, për çdo gradë apo nivel gradash, për punonjësit nenoficer dhe për gradat e nivelit të ulët e të mesëm për punonjësit oficer pranë Qendrës së Stërvitjes e Trajnimit Mullet, si dhe për gradat e nivelit të lartë për punonjesit oficer pranë Akademisë së Policisë, Akademisë Mbrojtjes apo dhe jashtë vendit. Kjo do të garantojë në çdo kohë rritje të nivelit profesional në planifikimin dhe kryerjen detyrave e shërbimeve, rritje e përkushtim në punë, si dhe ambicje e kërkesë në vetvete për përparim në gradë dhe karrierë, duke garantuar Gardën e Republikës në misionin e saj.

**SHEF E SEKTORIT TË BURIMEVE NJERËZORE
N/Kolonele Shqipe SPAHIU**

GARDA E REPUBLIKES FORCE SIGURIE ME STANDARTE PERENDIMORE DHE PERFORMANCE KOMBETARE

Nga objektivat kryesor në kuadrin e luftës kundër terrorizmit dhe ndër faktorët që ndikojnë në sigurinë e shteteve,, është dhe sigurimi i Personaliteteve të Larta Shtetore (PLSH). Në të gjitha sistemet qeverisëse, në të gjithë globin sigurimi i PLSH-ve është elementi i parë nga i cili fillon siguria kombëtare. Strukturat apo agjensitë që merren me sigurimin e PLSH-ve kanë të njëjtin mision, por me emertesa e sisteme organizimi të ndryshme sipas vendeve.

Berthama e përbashkët që keto formacione kanë është funksionimi mbi parimet e një shërbimi sekret i tillë që gjithë skenari i lëvizjeve detajohet dhe funksionon si një sistem i kriptuar.

zjarr, eskorta u godit nga plumbat e armeve automatike të terroristëve. Fale aftësive profesionale të Rreshterit More, makina Presidenciale arriti të largohej nga vendi i atentatit megjithëse kishte dy goma të shpuara. Truprojat që ndodheshin në makinat e tjera të sigurisë u zunë në befasi. Gjatë lëvizjes së mjetit VIP nga vendi i atentatit Presidenti Francez e mbante koken të ulur poshtë duke qëndruar si i vdekur. Kjo i bëri atentatorët që të mendonin se e kishin realizuar misionin e tyre. Pasi u bë evakuimi i Presidentit në një vend të sigurtë vihet re se makina kishte marrë shumë plumba automatiku dhe mitrolozi. Një nga këta plumba kishte goditur edhe në koken e sediljes së Presidentit Francez Charl De Gol . Pa prezencën e këtij



Duke realizuar detyrën e tyre këto shërbime jo pak herë kanë ndikuar në ndryshimin e rrjedhës së historisë. Ndërhyrja e specializuar e shërbimit të sigurisë së afërt ka qenë vendimtare për jetën e PLSH-ve, Atentati i organizuar për eliminimin e Charl De Gol President i Republikës së Francës të asaj kohe është një shembull ishte e nxehtë i ndollur në një situatë gjeopolitike të Evropës. Me njohjen e pavarësisë së Algerisë një grup, i një organizate kriminale kishte planifikuar deri në detaje eliminimin fizik të Presidentit të Republikës Franceze Charl De Gol. Atë ditë në rrugëkalimin ku atentatorët kishin organizuar pritën, eskorta Presidenciale nuk kaloi. Vendimi për ndryshimin e rrugëkalimit bëri të mundur që eskorta e Presidentit të Francës të mos bëhej objekt i goditjeve të terroristëve. Eskortat po kalonte në një tjetër rrugë kur një pjesë e grupit terrorist takoi rastësisht eskortën e Presidentit. Shoferi i makines VIP Rreshteri More ishte gjithmonë i vëmendshëm në drejtimin e mjetit, Ai e mbante mjetin në mes të rrugës në trafik duke krijuar mundësinë e zhvendosjes herë pas here në të majtë dhe në të djathtë gjë që ja bënte të pamundur këtij grupi goditjen e mjetit. Përsëri atentatorët nuk hoqën dorë, ata organizuan një tjetër skenar për eliminimin fizik të Charl De Gol. Një pasditë të po asaj jave kur eskorta po dilte nga pallati Preidencial ky grup terrorist i kishte zënë pritë Presidentit Francez. Në momentin e hapjes

shërbimi mbase nuk do të ishte realizuar ëndrra e Charl De Gol për një Europë të bashkuar dhe mbase do të kishim një tjetër hartë të Europës.

Atentate të shumta ndaj Personaliteteve të Larta janë bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Egjipt, Francë, Gjermani, Japoni, Izrael, Itali etj. Rastet e ndodhura janë studiuar në detaje për format dhe mënyrat e goditjes së terroristëve. Mbi këto eksperiencë ngatave shërbimet tona kanë përfeksionuar dhe ngritur sisteme për mbrojtjen e PLSH-ve.

Oficerët të tillë kanë dhënë dhe jetën e tyre për fatet e Atdheut. Major Llesh Topalli i shpëtoi jetën Mbretit të Shqipëtarëve duke u bërë mburoje e tij. Misioni për të cilin ai ra, u permbush, “ Sigurimi i Jetës së Mbretit” u realizua. Ky koncept për sigurinë është brumosur brez pas brezi.

Parime bazë për sigurimin e PLSH-ve në Degën e RM të PLSH-ve në Gardën e Republikës.

Detyra e Degës së RM të PLSH-ve si pjesë përbërëse e Gardës së Republikës është siguria fizike e PLSH-ve të vendit e ato të huaja që vizitojnë vendin tonë, në përputhje me Ligjin për Gardën e Republikës. Objektivi kryesor për realizimin me sukses të këtij misioni është trajnimi dhe kualifikimet brenda dhe jashtë vendit,



profesionalizmi në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi në rast situatash kërcënuese, në funksion të sigurisë së PLSH në përputhje me Ligjin.

Drejtimet kryesore të punës për përgatitjen profesionale si në disiplinat shkencore dhe ato formale të ndërthurura dhe në funksion të njëra tjetrës përbëjnë themelin mbi të cilin do të përvijohet figura e drejtuesve të strukturave në Degë dhe efektivit të Degës së RM të PLSH-ve. Organizimi i punës në grup, marrja e vendimeve dhe përmbushja e detyrimeve nga gjithsecili janë parësore në shërbimin tonë.

Planifikimi i hollësishëm i çdo operacion për sigurimin e PLSH-ve gjatë zhvillimit të aktiviteteve mbështetet nga njëra anë në procedura

rregulla janë gjithmonë të qarta dhe evidente në punën e efektivave të Degës R.M te PLSH-ve .Të jemi gjithmonë të informuar për njohjen reale të situates dhe të jemi të vëmendshëm ndaj çdo detaji.

- Saktësia në realizimin e detyrave që ngarkohen është element kyesor që ndikon në përballimin e një sulmi fizik të mundshëm ndaj PLSH-se, që ne sigurojme. Jeta e Përsosmërisë dhe e jona varen nga aftësia për të zgjedhur një menyrë të përshtatshme dhe të sakte veprimi dhe realizimi me sukses. Ngurrimi në këto raste është i barabartë me vdekjen. Rruga më e mirë për të arritur palëkundshmërinë taktike është planifikimi paraprak ose bërja e hipotezave; duke bërë pyetjen “ Ç’do të bëja unë **SIKUR** ?” Duke vepruar në mënyrë taktike gjejmë më lehtë zgjidhjet e sakta.

-Vetëkontrolli është një tjetër produkt i forcës së vullnetit dhe i stërvitjes. Sa më shumë ti imponojmë vetes kushte të stresit mendor dhe fizik gjatë stërvitjes aq më mirë do të përgatitemi për të përballuar rrethanat stresuese që mund të na paraqiten gjatë kryerjes së misionit për sigurimin fizik te PLSH-ve. Në rast se humbim kontrollin gjatë kohës kur mund të sulmohemi ka mundësi që mos të dalim gjallë nga ngjarja dhe të flasim për të. Ne duhet të jemi në gjendje ta kontrollojmë agresivitetin kur terroristët nuk pefaqsojnë më rrezik për PLSH-në.

-Vendosmeria në këtë kontekst ka të bëjë me përdorimin e të gjitha energjive dhe rezervave që kemi, pa kursyer asgjë, për tju përgjigjur menjëherë agresionit (sulmit) dhe për të bërë evakuimin e PLSH-ve nga zona e rrezikut.

Pikat e trajtuara me lart janë disa elemente në vija të përgjithshme që në Degën e RM te PLSH-ve po punohen dhe përmirësohen çdo ditë e më shumë.

Vlerësimi i situatave dhe marrja e vendimeve mbi baza sigurie janë prioritare që misioni për sigurimin e PLSH-ve të jetë i suksesshëm.



standarte veprimi të paracaktuara dhe nga ana tjetër një planifikim i hollësishëm duke përdorur të gjitha informacionet që disponohen. Për hartimin e një Plani Paraprak diskutohen detajet e aktivitetit, informacionet e marra dhe detyra të vecanta me Sektorët respektiv. Përpara nisjes për shërbim rifreskohen detyrat e personelit për aktivitetin që do të ndjekë. Përgatitja taktiko-psikologjike e efektivit të Degës RM të PLSH-ve. ka rëndësi të veçantë për të arritur sukses në realizimin e misionit për sigurimin e PLSH-ve në ambjente të hapura e të mbyllura si dhe në seli. Aftësia e vetëkontrollit dhe përqëndrim siguron një avantazh cilesor ndaj elementeve që mund të kenë qëllime terrori ndaj PLSH-ve.

-Kujdesi është tipar karakteri, por dhe mund të mësohet e të përmirësohet n.q.s jemi kërkues dhe i praktikojmë veprimet tona. Dy

Në konceptin e forcave perëndimore për sigurimin e afërt të PLSH-ve në aktivitete dhe seli është prioritare llogaritja e forcave, me qëllim që koficenti i sigurisë të jetë sa më i lartë. Shfrytëzimi i eksperiencave të shërbimeve tona dhe atyre homologe ka ndikuar në forme të drejtperdrejte në përmirësimin e punës .

Ne ceremoninë e festimeve të 80 vjetorit të Gardes së Republikës, në muajin Qershor Dega e RM te PLSH-ve demonstroi me se miri, një pjesë të kryerjes së detyrave nga ana e saj në funksion të sigurisë së PLSH-ve.

Major Admir. Abrija

NORMAT E EDUKATES DHE MIRESJELLJES, ETIKA E KOMUNIKIMIT, ETIKA E PUNES NE RAPORTIN E PROR – VARTES

Gjate gjithë vitit të kaluar në përmbushje të misionit të Gardës së Republikës në dinamikën e jetës dhe veprimtarisë së përditshme kemi analizuar probleme të ndryshme për detyrat, për gatishmërinë, për shërbimet, rregullin e disiplinën etj. Pra jemi përpjekur të rrokim aspekte nga e gjithë sfera e realizimit të angazhimeve dhe detyrimeve tona si punonjës të Gardës së Republikës. Faktor përfundimtarë në realizimin e objektivave e detyrave tona të shenjta jemi ne, oficerët, n/officerët dhe



gardistët. Barra dhe detyrimi që kemi marrë mbi shpatulla mes privacioneve e detyrimeve si gardistë, krahas atij ligjor, na bën të jemi më parë qytetarë, njerëz me norma të edukatës dhe mirësjelljes, me etikë të lartë komunikimi, e cila reflektohet në raport të hierarkisë së gradave dhe detyrës, në raport me komunitetin, me njëri – tjetrin e kudo në jetë, në familje, shoqëri e në gjithë veprimtarinë shoqërore. I gjithë ky proces zhvillimi ka si autor njeriun, tek i cili gjithçka duhet të jetë e bukur, mendja, shpirti, fytyra, veshja dhe tërë pamja e jashtme, fjala e gjesti, sjellja dhe edukata. Këto janë shfaqje të një personaliteti harmonik të zhvilluar bukur e në mënyrë të gjithanshme fizikisht, mendërisht, shpirtërisht.

Sa i shkojnë ato për shtat punonjësit në Gardë, oficerit, n/officerit dhe gardistit?

A mund të kuptohet qenia e zhvilluar njerëzore pa sjelljen e kulturuar?

A nuk e shëmton njeriun mungesa e edukatës?

A nuk e zbukurojnë dhe hijeshojnë atë fjalën e ëmbël dhe e mirë, përshëndetja e ngrohtë dhe dashamirëse, korrektësia dhe respekti në marrëdhënie më të tjerët, me një fjalë, ajo që ne e quajmë sjellje e kulturuar?

Shoqëria jonë shqiptare është thellësisht njerëzore. Kujdesi dhe respekti për njeriun janë shprehje e thelbit më të qenësishëm të saj, një shfaqje e ligjit me themel të jetës në Shqipëri. Por a mund të kuptohet ky qëndrim thellësisht njerëzor pa sjelljen e kulturuar? Absolutisht jo. Është kjo arsyeja që ne, sjelljen e kulturuar nuk mund ta barazojmë kurrë vetëm me paraqitjen e jashtme, me një kod të ngrirë rregullash formale e tradicionale. Ne nuk i nënvlerësojmë këto rregulla kur ato janë të arsyeshme dhe njerëzore, kur nuk u vjen erë anakronizëm, lustër e falsitet. Por sjelljen e kulturuar ne e shikojmë shumë më gjerë. E duam atë në radhë të parë në të gjithë llojet e marrëdhënieve,

si dhe në të gjithë jetën publike e qytetare. Dhe në shoqërinë tonë ajo nuk është një edukate qytetare e dhënë njëherë e përgjithmonë, një klishe e ngurosur që e kemi trashëguar dhe nuk mund ta prekim, një ikonë e shenjtë se cilës nuk mund as t'i heqim, as t'i shtojmë gjë. Ne flasim sot për edukatë qytetare të punonjësit gardist oficer, n/officer dhe ushtarit, kërkojmë formimin dhe edukimin e tyre me atë pasuri të vyer që brezat para nesh, gjyshërit e stërgjyshërit tanë na lanë si pasurinë më të madhe. Dhe ata na lanë jo pak, por shumë veti e virtyte si besa, trimëria, burrëria, fisnikëria, mikpritja, dashuria, cilësi e virtyte që në thellësitë e shekujve e deri më sot shqiptarin e bën zot në trojet e tij. Ndaj prindërit tanë na edukuan e mëkuan me porosi të tilla si:

Të shërbesh në Gardën e Republikës, është nder për ty dhe familjen, prandaj sillu mirë, respektoje eprorin dhe shokun, kryeje detyrën me vigjilencë, je i rregullt dhe i disiplinuar. Janë këto norma dhe këto porosi që në mënyrë më të natyrshme janë bërë pjesë e pandalshme e jetës dhe veprimtarisë sonë në Gardë.

Megjithëse ka vendin dhe specifiken e vet në jetën shpirtërore të shoqërisë dhe në figurën morale të njeriut, në vetvete edukata dhe sjellja e kulturuar është mjaft e gjerë. Sferat e shfaqjes së saj, pamjet konkrete që ajo merr shtrihen në shumë rrafshje. Secili prej tyre



materializohet e shprehet në norma e rregulla të caktuara, ne parime e tradita.

Nuk mund të mos dallojmë e të mos theksojmë në fushën e edukatës qytetare, para se gjithash kulturën e punës përgjithësisht dhe po ta specifikojmë problemin edhe me konkretisht, edukatën dhe sjelljen e kulturuar në punë, sidomos gjatë marrëdhënieve që lindin midis njerëzve në procesin e punës, në hierarkinë e gradave dhe detyrës, në marrëdhëniet epror – vartës, në kryerjen e detyrave të shërbimit dhe gatishmërisë në bashkëveprimin e Njësive dhe n/njësive me njëra – tjetrën, me grupet dhe n/grupet. Një trajtim i tillë i problemit përputhet plotësisht me botëkuptimin që e konsideron punën si faktorin kryesor të jetës shoqërore të njeriut. Për këtë është plotësisht logjike që kulturën dhe etikën e punës ta quajmë edhe si pamjen më themelore të edukatës qytetare. Problemi që trajtojmë ka të bëjë edhe me marrëdhëniet dhe etikën e

komunikimit ndërmjet punonjësve në Gardë, sidomos mes vartësve dhe eprorëve. Kuptohet se edhe në këto



marrëdhënie nga të dy palët kërkohen qëndrime korrekte dhe të kulturuara.

Sidomos për përgjegjësit, eprorët, është e palejueshme që në marrëdhënie me vartësit e tyre të mos kenë reciprocitet, mirësjellje, për më tepër duke përfutur nga të drejtat e tyre të natyrshme për të bërë vërejtje e kritika, për të kërkuar llogari, t'i bëjnë ato me taktin dhe dinjitetin e duhur, të mos tregojnë shenja mendjemadhësie e kapadaillëku, arrogance dhe prepotence.

Sigurisht, jeta ushtarake e veçanërisht ajo në Gardën e Republikës, ka veçoritë e veta. Njëra nga më të rëndësishmet prej tyre është nevoja e një disipline ushtarake, pa lëshime e qëndrime liberale, që kërkon zbatimin rigoroz të të gjitha rregulloreve e rregullave



ushtarake, të të gjitha urdhrave e kërkesave të eprorëve, që nga zgjimi në orarin e caktuar e mirëmbajtja e uniformës e deri në zbatimin me përpikmëri i çdo detyre shërbimi, stërvitore etj.

Pikërisht në këto rrethana mund të ndërtohen marrëdhënie me të vërtetë të kulturuara dhe gjatë shërbimit ushtarak midis gardistëve dhe eprorëve. Për këtë kërkohet që gardistët, n/officerët e në përgjithësi vartësit të dëgjojnë e të zbatojnë këshillat e porositë, mësimet dhe urdhrat e eprorëve të tyre.

Madje jo vetëm të respektojnë ato formalisht, por edhe t'i duan ato me gjithë zemër. Por, që t'ia arrihet kësaj, duhet që edhe eprorët të jenë të afërt e të dashur me gardistët, me n/officerët.

Sjelljen e kulturuar nuk mund ta kuptojmë edhe pa etikën e jashtme. Ajo përfaqëson një kod të tërë rregullash të pashkruara. Në pamjen e parë ato duken thjesht formale. Mirësjellja në marrëdhënie me njerëzit, me komunitetin në përgjithësi është e nevojshme dhe etikë.

Por të mos harrojmë se edhe populli i thjeshtë ka pasur gjithmonë etikën e vet, mirësjelljen karakteristike të tij. Kjo shprehet me përdorimin e lutjeve, të falënderimeve, të përshëndetjeve.

Duke përmbushur e realizuar detyrat, në gardistëve na qëllon shpesh të komunikojmë me qytetarët, me banorët, me intelektualë, me njerëz të sferave të ndryshme të jetës. Të gjithë jemi dëshmitarë se sa na mirëkupton opinioni i shëndoshe kur kryejmë detyrën për ruajtjen dhe sigurimin



e PLSH-ve. Kjo ka arsytet e veta, ku të parin do të vendosnim respektin që ka populli për Gardën si dhe merita jonë si gardistë kur sillemi me dashamirësi, me edukatë dhe kulturë gjatë ushtrimit të detyrës.

Janë të shumtë shembujt në Gardë që tregojnë se kemi oficerë, n/officerë model në marrëdhënie dhe komunikim me qytetarët.

Ketë rrugë lypset ta çojmë më tej, për të farkëtuar dhe konsoliduar marrëdhëniet e shëndosha me komunitetin. Realizimi i detyrave tona në përmbushjen e misionit si Gardë, kërkon njerëz me edukatë e mirësjellje qytetarë, me normat e etikës në punë, raporte të ndryshme eprorë – vartës, dhe në raport me komunitetin. Sjellja e mirë me qytetarin, dashamirësia e ngrohtësia ndaj tij në procesin e



realizimit të objektivave do të jete një lloj testi për të gjithë në që punojmë e kryejmë veprimtari në Gardën e Republikës.

N/KOLONEL QEMAL XHAFERAJ

SPORTI DHE KULTURA SI PJESE E PANDARE NE JETEN GARDISTE

Pavarësisht që në programet e Njësive janë parashikuar aktivitete sportive - kulturore pjesëmarrja masive e personelit të Gardës në gjallërimi i jetës sportive në Njësi e N/njësi, rritja e aftësive dhe formës fizike, përmirësimi i infrastruktures dhe terreneve sportive dhe përzgjedhja e elementeve për përfaqësim me dinjitet në veprimtaritë sportive, ishin në objektivi i organizimit të këtyre kampionateve dhe



konkurseve që u zhvilluan në shkallë Garde në kuadër të festimeve dhe përgatitjeve me rastin e 80 vjetorit të krijimit të Gradës.

Në hapësirën kohore të muajve Prill, Maj, Qershor terrenet sportive, fushat e futbollit, volejbollit, këndet sportive, poligonet u shndëruan në



një arenë të shpalosjes së shpirtit të garës, sedra për të fituar vende nderi dhe konkurimi dinjitoz në të cilin doli në pah përgatitja e lartë ushtarako-profesionale, teknike, fizike e të gjithë efektivave gardistë ishin diskutimi i ditës në çdo ambient gardist. Por pavarësisht këtij entuziazmi në efektivat e Gardës, zhvillimi i aktiviteteve kulturoro-sportive u realizua pa çenuar shërbimet në sigurimin e PLSH-ve dhe ORV-ve si dhe masave të planizuara nga drejtuesit e strukturave.



Ecuria e zhvillimit të aktiviteteve tregoi impenjim maksimal dhe pjesëmarrje masive të kuadrit oficer, n/officer por veçanërisht të atij gardist.

Këtë vit organizimi i aktiviteteve kulturoro-sportive përkoi me 80-vjetorin e Krijimit të Gardës së Republikës. Ky moment kulmor në historinë e efektivave gardist sherbeu për të gjithë personelin e Gardës si periudhë mobilizimi, konkurimi dhe përgjegjësie të lartë për të realizuar synimet dhe objektivat në ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurinë e PLSH-ve, si dhe ORV-ve.

Në keto aktivitete u duk qartë dinamizmi, shpirti sportiv, konkurimi me dinjitet i të gjithë efektivit gardist duke shpalosur vlerat përgatitjet e tyre në shumë disiplina sportive por edhe në konkurse të ndryshme si: në kampionatin e futbollit, kampionatin e volejbollit, në garat e vrapimit, të tërheqjes së litarit, në konkursin e këngës së Gardistit, të



armatimit, të hapit treshor, qitjes si dhe në konkursin e grupeve artistike ku zbulohen edhe talentet e reja nga efektivat gardist.

Në mbyllje të aktiviteteve u organizua nga Shtabi i Gardës së Republikës edhe ndeshja finale e kampionatit të futbollit si dhe ndarja e kupave për secilën disiplinë ku morën pjesë:

Komandanti i Gardës Gjeneral Ndreja Prendi, Kryetar i forumit "Imazh & Media" Dr. Astrit Memia, si dhe drejtues të lartë të Gardës, të cilët dhanë edhe trofetë për secilin fitues sipas Njësive.

Vendin e parë më me shumë pikë të fituara gjatë gjithë aktiviteteve të zhvilluar në kuadër të festimeve me rastin e 80 vjetorit të krijimit të Gardës së Republikës e zuri Njesia e Parë. Në përfundim të aktivitetit Komandanti i Gardës duke përshëndetur të gjithë efektivat e Gardës që morën pjesë në keto aktivitete kaq të larmishme dhe të rëndësishme i uron gjithashtu gëzuar 80 vjetorin e Krijimit të Gardës së Republikës.

SI TE MOS BIEM "PRE" E KONSUMIMIT PROFESIONAL.

Qënia njerëzore është një krijesë unike dhe shumë komplekse. Tek çdo njeri mund të gjejmë veçanti dhe karakteristika të cilat mund të jenë të vështira për tu takuar tek persona te tjerë.

Gjatë jetës së tij, njeriu kërkon dhe duhet të ketë ambicie për të formuar çdo anë që përbën karakterin e njeriut dhe ploteson figurën e tij. Në këtë drejtim, përveç edukatës familjare dhe kulturës që përfitojmë nga njerëzit më të afërt që na rrethojnë (kultura që përbën 7-vjecarin e parë të jetës së njeriut), ne përpiqemi të plotësojmë mozaikun jetësor duke përfituar nga të mirat dhe shërbimet që na ofron shoqëria dhe qytetërimi.

Për të qënë sa më të aftë për tu përballur me jetën dhe për të shfrytëzuar mundësitë që na ofrohen, njeriu përpriqet të formojë një nivel profesional.

Kjo përpjekje për tu rritur profesionalisht, fillon rrugën që në momentin e kur njeriu vendos të shkollohet, trajnohet, të përfitojë eksperiencën të vlefshme në mënyrë të ndryshme, si për shembull: vullnetarizmi, praktikimi në terren i teorisë së përfituar etj.

Pasi përpriqesh profesionalisht (kjo nuk ka një pikë arritje, duhet të përpriqesh gjithmonë për më të mirën) mund të jepet mundësia ku secili prej nesh, të shfaqë këtë profesionalizëm dhe të ndjejë përfitimet që vijnë nga ky shkak.

Kjo është një pikë arritje dhe në këtë moment njeriu është i gatshëm të shfaqë anën e tij profesionale, duke u përballur me vështirësitë, sfidat apo edhe me kënaqësitë që na ofron punësimi.

Në një moment të caktuar, por te ndryshueshem tek çdo njeri, mund të shfaqet konsumimi profesional.

Termi **konsumim profesional** u përdor për herë të parë në vitet 70, në një institucion social, për disa punonjës që shfaqnin lodhje fizike dhe emocionale.

Përcaktimi më i saktë dhe më i drejtë për termin konsumim profesional mund të jepet në tre variante kryesore:

1. Konsumimi profesional është një lodhje fizike dhe mendore e shkaktuar nga ekspozimi për një kohë të gjatë i individit ndaj situatave që shkaktojnë lodhje emocionale.
2. Një gjëndje e natyrshe e parashikueshme që mund të parandalohet.
3. Konsumimi profesional është proces që fillon me ekspozimin ndaj stresorëve, pastaj fillon përkeqësohet në mënyrë graduale.

Autorë të ndryshëm argumentojnë dhe kanë arritur në përfundimin se faktorët kryesorë që ndikojnë në konsumimin profesional kanë lidhje me individin, mjedisin ku punohet, shoqërinë etj.

Më konkretisht, roli i individit është një faktor që çon në konsumim profesional. Kështu, psikologjia personale, nevojat tona si qenie njerëzore, kuptimi ynë për veten,

ndikojnë drejtpërdrejtë në konsumimin profesional. Persona me karakteristika të veçanta si për shembull vetëvlerësim i ulët, mungesë besimi etj, janë më të prekur nga konsumimi profesional.

Mjedisi ku punohet, është faktor shumë i rëndësishëm për konsumimin profesional. Në këtë mënyrë, ngarkesa në punë, rolet e dyfishta që ka të bëjë me mungesën e qartësisë për të drejtat, përgjegjësitë, statusin etj, bëjnë që konsumimi profesional të jetë më i shpejtë.

Mardhëniet me kolegët ndikojnë gjithashtu në stërmundim dhe lodhje emocionale. Nëse mardhëniet me kolegët nuk janë të mira, atëherë ato bëhen burim konflikti dhe burim stresi. Por nga ana tjetër nëse kolegët kanë mardhenie pozitive, japin e marrin me njëri-tjetrin, bisedojnë për të ndarë problemet, atëherë mundësia e stërmundimit është më e vogël.

Dallimi mes gjinive (seksizmi). Ky faktor vërehet sidomos në profesione që hamendësohet se mund të ushtrohen vetëm nga burra, të tilla si: police, oficerë, politikane etj. Ky faktor bën që gratë në këtë rast të ndjehen më të ulëta profesionalisht dhe si pasojë ndjeshmëria ndaj stresit dhe lodhjes është më e madhe.

Disa këshilla se si të shpëtojmë nga konsumimi profesional:

Rëndësi e vecantë në literaturë i kushtohet menaxhimit të stresit ku shpesh rekomandohen teknika relaksuese, ushqim i mirë, pushimi, ulja e konsumimit të kafesë, cigareve, alkoolit mos përdorimi i drogës etj.

Në anën profesionale këshillohet:

- vendosja e qëllimeve realiste
- vetëdija, kuptimi, njohja e mirë e vetes me burimet dhe kufizimet.
- mbështetja teknike
- mbështetja emocinale
- përmirësimi profesional duke u trajnuar, duke zhvilluar programe për tu plotësuar profesionalisht
- leximi i literaturës për të rifreskuar njohuritë profesionale
- axhendë e ekuilibruar dhe e përcaktuar me afate kohore
- këshillimi me kolegët dhe ofrimi i ndihmës për njëri-tjetrin
- mundësia për të patur ditë pushimi

Jashtë vendit të punës, profesionistët duhet të përfshihen në aktivitete që ulin nivelin e stresit të tilla si: kalimi i kohës me anëtarë të familjes, frekuentimi i rrethëve shoqërore, marrja e ushqimit dhe pushimit të mjaftueshëm, leximi për kënaqësi, dëgjimi i muzikës, ushtrime fizike, shëtitjet në ajër të pastër, përfshirja në punët në komunitet etj.

Rreshtere B. Osmani

PER NJE MENDIM ELITAR DHE NJE ELITE INTELEKTUALE

Një shoqëri nuk mund të jetë me një organizim struktural solid pa një shtresë intelektuale që përbën elitën e mendimit dhe zhvillimit në tërësi dhe formon atë që quhet vlerë integrimi i çdo kombi. Përfaqësuesit e këtyre vlerave, elita intelektuale është ajo që përcakton përparimin shoqëror, vullnetin e një shoqërie që përputhet me stadin e zhvillimit dhe pretendimeve, është institucioni i mendimeve, laboratorit që përpunon vlerat njerëzore në kundërvënien me antivlerat dhe forcat regresive. Në orientimin e ri të shoqërisë sonë pluraliste duke iu referuar mendimit të lirë, lëvizjes dhe veprimtarisë së lirë ekziston një fenomen që shoqëritë e tjera të zhvilluara e kanë kaluar, por që tek ne është problem virtyti e morali por edhe civilizimi.

Ky fenomen shfaqet në formën e abuzimit me intelektualizimin dhe individualizimin intelektual dhe kjo vjen pikërisht prej intelektualëve mediokër që nuk plotësojnë as formatin mesatar të njerëzve të ditur. Ata me një personalitet të munguar marrin përsipër çështje apo probleme madhore për zgjidhje ndërkohë që janë krejt jashtë mundësive të kapacitetit të tyre njohës e veprues. Por kjo shtresë e vetshpallur intelektuale është ambicioze dhe ambiciet e saj janë cinike ashtu si vetë formimi i saj sipërfaqësor e i përciptë që demonstroi.

Duke u paraqitur me civitë (CV) e tyre të fryra (disa edhe me grada shkencore) bëjnë heroin e shkuar, heroin e tashëm dhe shpëtimtarin e së nesërme, ndonëse ndodh e kundërta.

Logjika e të "qënit dikur dikushi" shërben si bazë e prezantimit pseudointelektualist të tyre duke harruar se logjika e të "qënit dikur dikushi" është atavizme e mentalitetit se ai që ka qënë njëherë do të jetë përgjithmonë.

Ky lloj intelektual është i kudogjendur, merr vesh në të gjitha fushat, jep udhëzime, konstaton, aludon, nxjerr konkluzione, vetshpallet i ditur, hero, lider, disident, parashikues, profesionist, reformator, gjithçka e asgjë njëkohësisht, por si racë parazitare që fatkeqësisht ekziston midis nesh përbën një nga sfidat më serioze e delikate të demokracisë sonë të brishtë. Kontigjenti kësaj shtrese vegjetuese vjen nga "aristokracia" e sistemit që lamë pas dhe është e ngjizur që në embrion me genin më të ulët destruktiv të racës.

Këta personifikues të "inteligjencës popullore" amalgamë e rrezikshme e një kategorie njerëzish te privilegjuar në kurriz të një populli të traumatizuar nga bombardimet ideologjike kanë gjetur terren duke krijuar një tymnajë vetreklamimi ku ravijëzohet vizioni i tyre feudo-klanor që ska asgjë të përbashkët në mendimin e vërtetë intelektual që është shtylla vertebrale, ashti që mban në këmbë dhe e përsos procesin e përparimit shoqëror.

Kur ndodhin ndryshime pozitive këta pseudo nxitojnë kafeneve e ambienteve të ndryshme duke shprehur pakënaqësi, duke lëshuar mendimet e tyre aty-këtu si vezët e qyqes, duke paragjykuar e duke deklaruar se po të ishin ata drejtuesit "do t'i bënin gjërat ndryshe".

Zhvillimet shoqërore të fundit, procesi kompleks i reformave, standartet e reja që na çojnë drejt pranimit në NATO e BE krijojnë një klimë të disfavorshme për pseudointelektualët dhe terreni i mendimit të tyre sa vjen gjithnjë e duke u ngushtuar.

Tashmë standartet janë të vendosura : Konkurrencë e lirë idesh; konkurrencë e lirë vlerash.

Të humburit në këto kushte janë destruktivët dhe pseudot e çdo rrafshi. Ata që kanë marrë fatet e demokracisë shqiptare mbi supe janë personalitete të vlerave mirëfilli intelektuale e duke u pasuruar me elementë të rinj do të përçojnë tjetër mendim intelektual, tjetër hapësirë të menduarit e vepruarit dhe si të tillë i paraprijnë vendosjes së gjërave në vëndin e duhur dhe ne shqiptarët, do të integrohemi në Europën moderne.

KUR TË BËHESH NJË

Ç'të kujtojë më parë
E kujtesa
Ç'të hedh pas krahëve
Në lojën e fatit tënd të egër

Kombi im epik
Me histori të kryqëzuar

Fisnik në pamje
Në shpirt e gjithçka

Kombi im vital
Me histori të kryqëzuar

Të ndanë përgjysmë
E gjysmat
Gjysmë t'i lanë

Kombi im i shenjtë
Me histori të kryqëzuar

Sillet rreth teje ogurmire
Europeançe të buzëqesh
Europa moderne

Kombi im i lashtë
Me histori të kryqëzuar

Kombi im i ndarë
Kur të bëhesh
NJË
Dritë e bardhë ndër mote
Do të jetë mes kombeve
Prania jote !

nga N/Toger Gjin Gjonpali

Cikel me poezi nga Zana Gramshi

Mosha ime e rinise

Per shpirtin tend te ndezur
Me shprese yje te veshur
Mosha ime e rinise
Te kam kerkuar.

Perhere ti me je fshehur
Me mallin tend jam dehur
Per vitet e tua.

Te terkoj e te pyes ku me je
Seç me thua, jam ketu e jam atje
Zemra ime, rreh si me pare
Veç mbi floke kam nje re te bardhe

Jo. Ti kurre s'me ke braktisur
Neper vite udhen veç ke nisur
Per tu kthyer prap ne zemren time
Me kujtime dhe plot enderrime

Mosha ime e rinise.

Zemra ime, det

Vjen val' e detit
E puthet me bregun
Nje er' e lehte
Feshferine mbi gjeth

Malli im i djegur
Mbeti lot pa tretur
Ne buzet e etura
Per nje fjale, nje shprese

Zbret nje zog nga qielli
E qendron mbi dege
Fryn e shfryn nga malli
Zemra ime det

Te kerkoj ne enderr
Zgjohem me nje shprese
Behu val' e detit
Behem une nje breg.....

Kish nje kenge ate mbremje.

Nuk kish klithma ate mbremje
Nuk kish mall
Ca endrra rendnin drejt nje zjarri
Plot me zjarr

Nuk kish dallge ate mbremje
Nuk kish det
Ca vale rendnin drejt nje bregu
Bregu det

Nuk kish peme ate mbremje
Nuk kish flete
Ca flete rendnin drejt nje rruge
Porsi blete

Kish puthje ate mbremje
Si asnjehere
Puthja puthjes seç i thoshte
Neper terr

Kish nje kenge ate mbremje
Kish nje emer
Buzet lehte peshperisnin
Te kam zemer.

REDAKSIA

KRYEREDAKTOR

ALTIN PRENDI

email: altinprendi@gmail.com

REDAKTORE

ZANA GRAMSHI

BASHKEPUNETORE

DR. ASTRIT MEMIA

ALKET ISLAMI

AGIM DOÇI

ADRESA

Rr. Perlat Rexhepi
Tirane, Albania

Tel: ++ 355 04 233606

www.garda.gov.al

